



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 4 QERSHOR 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 04. JUNA 2015. GODINE**

**QERSHOR - JUNI
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme,
4. Interpelanca e ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, për përgjegjësinë lidhur me procesin e demarkacionit të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi,
5. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit të Posaçëm për zgjedhjen e dy (2) gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor për cilësinë e grurit të importuar,
8. Zgjedhja e një (1) anëtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje Zapisnika sa prethodne sednice,
4. Interpelacija ministra Spoljnih poslova Republike Kosova, g. Hashim Thaçi, o odgovornosti u vezi sa procesom demarkacije granice između Republike Kosova i Republike Crne Gore,
5. Razmatranje Preporuke Posebne komisije za izbor dvoje (2) sudije u Ustavnom sudu Republike Kosova,
6. Razmatranje Izveštaja Komisije za zakonodavstvo, mandate, imunitete, Poslovnik Skupštine i nadgledanje Agencije protiv korupcije o nadgledanju sprovođenja Zakona o izvršenju krivičnih sankcija,
7. Razmatranje Izveštaja Komisije za poljoprivredu, šumarstvo i životnu sredinu i prostorno planiranje o kvalitetu uvezene pšenice,
8. I zbor jednog (1) člana Nezavisnog nadzornog saveta za Civilnu službu Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Ramush Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

E mora fjalën jashtë rendit të ditës për një temë që ka qenë e paraparë të jetë sot në rend të dite - Interpelanca me zëvendëskryeministrin, kryeministër i mëhershëm, ministër i Jashtëm, për kryeministër të tashëm nuk e di a ta them, që ka të bëjë me një temë, e që është demarkacioni i kufirit Kosovë - Mal i Zi.

Më vjen keq që zoti Thaçi nuk është në takim për shkak se në këtë temë është përgjegjësia direkt e tij, ka udhëhequr me Ekzekutivin në mandatet më përpara dhe është ministër i Jashtëm tash, se jemi njoftuar me shkrim se nuk do të jetë i pranishëm. Të thuhet gjërat më thjesht, kjo temë nuk ka ndonjë karakter ndonjë garë ndërmjet partive, kjo temë është serioze, e për t'i treguar që është serioze, populli e ka një fjalë të veten: "Toka me fjalë si vyen askujt". Zoti Thaçi dhe Qeveria e Kosovës ia kanë dhënë një tokë me fjalë Malit të Zi. Pra, një tokë për të cilën nuk pajtohen pronarët e saj.

Kosova dhe Mali i Zi i kanë kufijtë e vet, i kanë pasur të demarkuar më herët dhe këta kufij janë prej Jugosllavisë së dytë. Populli i njeh si kufij që nisin me Qafën e Çakorrit. Ajo është përdorur si qendër për t'u dhënë drejtim kufijve të mëtejme, e pastaj kanë shkua nëpër majat e larta bjeshkëve si kufij natyrorë, por që më vonë edhe janë shënuar si të tillë, pra qysh më '74 si të tillë.

Ajo që ka ndodhur në kohët e fundit me demarkacion nuk rezulton kështu. Pra, e kemi një vijë kufitare ose shenja të shënimit të vijës kufitare që ka depërtuar në brendi të territorit të Kosovës.

Zoti Thaçi dhe ata që e kanë krijuar këtë gjendje duhet ta riparojnë atë gjendje. Pse po e them duhet riparuar?

E para, nuk besojmë që Mali i Zi ka mbetur në bjeshkët tona në bjeshkët e Kosovës, se ka bjeshkë mjaft. Në rast se ka dikush bjeshkë për t'i dhënë, le t'ia japë pronën e vetë, por jo pronën e Kosovës.

E dyta, ne jemi të interesuar dhe që mendoj shumë, ashtu si Kosova që ka nevojë për fqinjësi të mirë me Malin e Zi, edhe Mali i Zi ka nevojë për një komshi të mirë, e jo për një komshi me të cilin është në fjalë për tokë. Në rast se Qeveria e Kosovës nuk e merr seriozisht këtë temë dhe nuk e rikthen vijën e kufirit aty ku ka qenë më '74-së, Qafa e Çakorrit, majat e larta që i dinë të gjithë dhe i kanë respektuar më herët, i ka respektua edhe Mali i Zi edhe ne, atëherë ajo me vetëdije po ja krijon një problem të madh Kosovës.

Temën për interpelancë në emër të Grupit Parlamentar kërkoj ta shtyjmë për një kohë kur të jetë ministri Thaçi dhe kur të jetë Kabinet qeveritar që të na japin një përgjigje.

KRYETARI: Faleminderit! Xhevahire Izmaku, nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot unë e kam një temë, të cilën ma kërkuan për muaj rresht dhjetëra nëna të reja të cilat kanë shqetësim për kualitetin e ushqimit që u servohet fëmijëve të tyre nëpër çerdhet publike të komunës së Prishtinës, por ky problem mund të jetë edhe më i gjerë.

Po marr shkas në përcjellje të festës së 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, dhe po e ndaj me ju, kolegë deputetë, një shqetësim lidhur me mënyrën se si ushqehen fëmijët tanë nëpër çerdhet publike, po kjo temë sigurisht nuk ndalet vetëm këtu, se mund të jetë edhe për çerdhet private.

Më datën 1 Qershor, secili nga ne ndau nga pak nga dita e vet për ta përcjellë një aktivitet, së paku për fëmijët, duke filluar nga Kuvendi i Kosovës, me një seancë të stimuluar, e cila doli shumë simpatike, sigurisht i qëlluar dhe fjalimi i kryetarit të Kuvendit dhe porosinë me mesazhe që u adresohen fëmijëve në sallë dhe jashtë saj.

Po ashtu, më bëri përshtypje pozitive edhe aktiviteti i kryetarit të Komunës së Prishtinës, zoti Ahmeti, dhe mënyra se si ai komunikonte me fëmijët ulur në mesin e tyre dhe rrëfimin e përrallave për ta.

Mirëpo, ne sot kemi nevojë ta trajtojmë shumë më seriozisht kujdesin për ta, duke ditur se dekadën e fundit po shtohen gjithnjë e më tepër rastet kur fëmijët e vegjël bëhet obezë, ose kanë problem me sheqernat dhe yndyrat në gjak. E kohëve të fundit, edhe te ne e kemi të shtuar numrin e fëmijëve të cilët edhe rezultojnë me sëmundjen e leukemisë, që edhe në vendin tonë është bërë shumë e dëgjuar, fatkeqësisht. Kjo vjen edhe si pasojë e konsumimit të ushqimeve të përpunuara dhe me shumë kalori, por edhe si mungesë e aktivitetit fizik.

Fëmijëve të nivelit parashkollor, si ata nëpër çerdhe, apo nëpër kopshte, në shumë raste ofrohen edhe racione të ushqimit ku zakonisht në institucionet publike menyuja është e përcaktuar nga drejtuesit, ndërsa në institucionet private merren edhe me mendimet e prindërve dhe vendoset një menyu me pëlqimin e tyre.

Sot do të flas për një menyu, të cilën e kam përcjellë me muaj të tërë nëpër çerdhet publike të komunës së Prishtinës, menyu e cila është tepër larg së dëshiruarës. Në shembull konkret, nëse një fëmijë e di nga dita e sotme që ditën e hënë do të ketë fasule në drekë, të enjten lakra të ziera, e të premten gjithmonë makarona, ka ikur koha e menysë së pandryshuar, sepse vendosja e menysë së ushqimeve që shërbehen nëpër kopshte çerdhe sot më shumë se kur ka nevojë të bëhet edhe nga një nutricioniste.

Pra, institucionet tona, duke u nisur nga ministria, drejtoritë komunale, duhet shikuar me kujdes nëse fëmijët tanë po ushqehen ose jo shëndetshëm. Së paku këta fëmijë të vegjël që askush s'i pyet se çfarë dëshirojnë të hanë për asnjë ditë të vetme brenda javës.

Në kopsht e në çerdhe punohet që fëmijët, jo vetëm të ushqehen shëndetshëm, por edhe të edukohen për të pëlqyer ushqime të shëndetshme.

Kudo nëpër vendet normale, ato vende me zhvillim, që ne i kemi si model, fëmijëve u bëhen prezantime të ushqimeve, si dhe organizohen lojëra të ndryshme me ushqime, nga të cilat ata mësohen të gatujnë edhe gatojca të ndryshme dhe të hanë me shije.

Mendoj që ka mundësi me pak më shumë vullnet dhe përgjegjësi që ne si institucione t'u ofrojmë nënave të cilat punojnë një rahat shpirtëror për ushqimin që u servohet fëmijëve të tyre, për gjithë një ditë që ato nuk janë pranë fëmijëve të tyre.

Duke e ditur, pse jo edhe si nënë, që jo të gjithë fëmijët e kanë të njëjtin karakter edhe në kulturën e të marrit të ushqimit, disa nga ta janë edhe tekanjozë, e kaq pak ka hapësirë që të ketë një kolorit përzgjedhjeje për ta. Pastaj, edhe nënat e lodhura, sapo i marrin fëmijët, u duhet që pa u ulur ende në shtëpi të merren me përgatitjen e ushqimit për ta.

Me gjithë respektin për punën që kryen stafi dhe edukatorët kudo nëpër këto institucione, sepse shumica nga ato e kanë një përgjegjësi dhe sjellje shembullore, sigurisht që e kujtoj që nuk është punë e tyre të propozojnë menyu, derisa fatbardhësisht nuk kemi raste as të helmimit, por as raste të tjera që rrezikohet siguria e tyre.

Fëmijët tanë, të gjithë pa dallim, nëpër çerdhe publike e private, duhet të kenë ushqim shumë të shëndetshëm, të kontrolluar, t'u afrohet me kreativitet, me lojëra e me dashuri. Institucionet lokale dhe qendrore ta marrin me seriozisht këtë çështje, sepse vetëm gjatë këtij viti kemi pasur disa herë shqetësime në këtë drejtim.

Prindërit të jenë më kureshtarë për menytë që u servohen fëmijëve të tyre, sepse s'ka asnjë kuptim që një menyu të mos ndërrohet për një vit dhe të mos ketë asnjë reagim këmbëngulës në këtë drejtim. Sot ekzistojnë shumë mundësi, e ne ta shfrytëzojmë vetëm njërën nga to është e

pakuptimtë. Ushqim të shëndetshëm për fëmijë të shëndetshëm! Parimi kryesor është ushqyerja e fëmijëve në mënyrë të këndshme dhe pa detyrim, duke i respektuar liritë e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shpejtim Bulliqi, në emër të Grupit Parlamentar Lidhja Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Zoti kryetar i Kuvendit,

I respektuar Kabinet qeveritar.

Të respektuar kolegë deputetë,

Qytetarë të respektuar,

Çështjen të cilën dua ta ngre sot në diskutimin tim është problematika e resurseve ujore në territorin e Kosovës, e me theks të veçantë për disa shkrime të ditëve të fundit nëpër mjetet e informimit lidhur me diskutimet rreth faktit se kujt i takon Liqeni i Gazivodës.

Aktualizimi i këtij problemi lidhet edhe me nevojat gjithnjë në rritje për resurset ujore, si rezultat edhe i rritjes demografike, por edhe i proceseve të urbanizimit dhe të proceseve të tjera që shtojnë nevojën për sasi më të mëdha të ujit.

Liqeni i Gazivodës, i ndërtuar në vitin 1977 në rrjedhën e epërme të lumit Ibër, me një sasi të akumuluar të ujit prej 390 milionë metrash kub, është njëri prej liqeneve artificial më të rëndësishëm për Kosovën.

Deklaratat e ditëve të fundit nga zyrtarët e shtetit të Serbisë lidhur me Liqenin e Gazivodës se gjoja ky aset qenka i padiskutueshëm si resurs natyror i tyre, nuk është asgjë më pak se një pretendim i ri territorial i këtij shteti ndaj vendit tonë.

Liqeni i Gazivodës është në suazat e resurseve natyrore më të rëndësishme të Kosovës, kur kihet parasysh fakti se uji është njëri prej resurseve më strategjike për të ardhmen, për faktin se vendi ynë llogaritet si njëri prej vendeve që posedon resurse ujore jo të mjaftueshme, pasi me 1 700 metra kub për kokë banori gjendemi në kufirin e stresit për ujë, të cilën situatë patën rastin ta provojnë para sa vitesh banorët e shumicës së regjioneve të Kosovës.

Liqeni i Gazivodës me sipërfaqe prej 9,91 kilometër katror, pothuajse në pjesën më të madhe të tij, diku me 74% të kësaj sipërfaqeje, ndodhet në territorin e Kosovës, dhe vetëm 26% e tij është jashtë kufirit të Kosovës, ose thënë në gjatësinë e përgjithshme prej 10,5 kilometrash është në territorin e Kosovës, ndërsa 0,5 kilometër, përkatësisht maksimumi 2,1 kilometër, kur është kota maksimale, kalon në territorin e Serbisë.

Ky fakt është i mjaftueshëm që institucionet tona edhe gjatë fazës së diskutimeve të Brukselit duhet të kenë parasysh që në asnjë mënyrë të mos jenë të papërgatitura në rastin kur të futen në këtë temë lidhur me të ardhmen e resurseve ujore të Liqenit të Gazivodës.

Së dyti, uji i këtij liqeni është jashtëzakonisht i nevojshëm dhe imediat për veprimtari, siç janë bujqësia, industria, vendbanimet, e kështu me radhë, që zhvillohen me theks të veçantë në regionin e Kosovës, sepse përmban diku 86,2% nga vëllimi i të gjitha akumulacioneve të cilat shtrihen në Kosovën verilindore.

Së treti, ky akumulacion është me vlera të larta hidroenergjetike për Kosovën. Në të janë instaluar turbinat me kapacitet hidroenergjetik prej 2X17 megavat orë energji elektrike.

Jemi të vetëdijshëm se të gjitha rrjedhjet ujore kryesore të Kosovës presin vijat kufitare të saj, por se njëra prej atyre me rëndësi të veçantë është lumi Ibër dhe Liqeni i Gazivodës.

Kjo ndodh për faktin se ndodhet në një regjion, i cili ka së tepërmi nevoja të mëdha për ujin.

Çështjet e ndryshme të ujërave transkufitare do të duhej të rregullohen në bazë të konventave dhe protokolleve të marrëveshjeve ndërshtetërore, duke i respektuar standardet ndërkombëtare që përfshijnë aspekte të ndryshme kualitative dhe kuantitative të ujit.

Prandaj, edhe një vërejtje - arsyeja e këtij diskutimi është që grupit tonë për bisedime në Bruksel edhe një herë paraprakisht t'i tërhiqet vëmendja që në suazat e këtyre diskutimeve të angazhohen ekspertë, të cilët merren me këtë lëmi dhe të cilët i njohin jashtëzakonisht mirë këto probleme, në mënyrë që të mos rrezikohet në asnjë formë ky resurs natyror i Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albin Kurti, nga Lëvizja “Vetëvendosje, në emër të Grupit Parlamentar, e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Në emisionin PULS të KTV-së, të hënën, më 1 qershor 2015, gazetari Mefail Bajçinovci e publikoi një raport konfidencial të EULEX-it, për të cilin EULEX-i njëherë heshti e pastaj e kontestoi, por nuk e mohoi. Ky raport tregon se si zyrtarë të lartë në EULEX janë të lidhur me zyrtarë të lartë në Qeverinë e Kosovës e në PDK, gjithnjë për interesa të ngushta dhe assesi për ato të Kosovës e të drejtësisë.

Sikur dënimi i Grupit të Drenicës, po ashtu edhe synimi për themelimin e Gjykatës Speciale po dalin të jenë të komprometuara nga ndërhyrjet politike. Kështu, Gjyqësori, Ekzekutivi dhe Legjislativi në Kosovë, jo vetëm që nuk janë pushtete të ndara, por ato më shumë merren me njëra-tjetrën, sesa me fushëveprimet e posaçme përkatëse që i kanë. Njëkohësisht, nga ky raport del që aktorët e ndryshëm politikë të PDK-së, në luftën e tyre të brendshme për pushtet personal në shtet e parti, nuk kursejnë asnjë mekanizëm shtetëror, e institucion demokratik.

Se shteti është i kapur tregojnë disa konkluzione të këtij raporti:

1. PDK-ja do kontroll të plotë të krijimi i Gjykatës Speciale;
2. PDK-ja do që të shpëtojë nga kapacitetet hetuese të EULEX-it brenda Kosovës;
3. PDK-ja ka qëllim që Kosova të shkojë në zgjedhje në pjesën e fundit të vitit 2015, ose muajt e parë të vitit 2016;
4. PDK-ja do që të lirohet më në fund Grupi i Drenicës para se të vijë zgjedhjet në shtator 2015, ose mars 2016;
5. Gjykata Speciale të themelohet në janar 2016;
6. PDK-ja të ketë zë (pjesën e saj) në hartimin e listës së personave të mundshëm që do të akuzohen;

7. PDK-ja ta ketë ndikimin e saj në strukturën e Gjykatës Speciale, pra për gjykatësit dhe prokurorët aty.

Mirëpo, leximi për drejtuesit e institucioneve në Kosovë është i njëjtë si ato që kemi parë në analizat për krerët e familjeve mafioze:

1. Hashim Thaçi planifikon të bëhet president i Kosovës, në mënyrë që të qëndrojnë personalisht mënjane nga themelimi i Gjykatës Speciale;
2. I njëjti po orvatet ta sigurojë postin e kryeministrit për ministrin aktual të Drejtësisë, Hajredin Kuçi;
3. Kadri Veseli dëshpërueshëm dëshiron të bëhet kryeministër;
4. Kadri Veseli planifikon ta sulmojë në të gjitha mënyrat ministrin aktual të Drejtësisë, Hajredin Kuçi, duke e diskredituar atë;
5. Hashim Thaçi dhe Hajredin Kuçi, në njërin anë, dhe Kadri Veseli, në anën tjetër, janë duke u përpjekur për të marrë kredi për lirimin e Grupit të Drenicës, në mënyrë që të marrin vota përbrenda partisë dhe në zgjedhjet e përgjithshme.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Interesat e tyre personale nuk ndalen vetëm me kaq. Ato shtrihen edhe te EULX-i. Atje, ta zëmë:

1. Ish-shefi i Divizionit Ekzekutiv, Mac Mason, synon ta marrë pozitën e kryetarit të Gjykatës Speciale;
2. Ish-shefi i EULEX-it, Bernd Brochard, edhe me ndihmën e asistentes së tij Papa, ka aspiruar të bëhet shef i mbrojtjes së përbashkët dhe i politikës së sigurisë në BE.

Nga ky raport shihet që te politikanët që janë në krye të institucioneve të Kosovës nuk ka më as interes partiak, e madje as grupor, por vetëm dhe vetëm interes personal. Ka mundësi që Grupi i Drenicës është grupi i fundit. S'ka më grupe! Ka vetëm individë me interesa personale. Me këtë logjikë nuk ka shtetndërtim e zhvillim. Madje, edhe angazhimin për Grupin e Drenicës këta krerë institucionesh e kanë pasur për interesa personale, e jo për UÇK-në, jo për drejtësinë dhe jo për të vërtetën. Me këso motivesh ata sigurisht që vetëm dëm kanë bërë.

Kur shteti është i kapur e krerët institucionalë janë të zhytur në krim e korrupsion, veprimet e guximshme si ai i gazetarit Bajçinovci janë shtetndërtuese dhe demokratike. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit për poezitë! Poezi të forta! Urdhëro, zoti Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ju po e quani “poezi”, po unë do ta kisha quajtur një “përrallë të zakonshme”. Nuk është hera e parë që jemi mësuar të dëgjojmë këso lloj shpifjesh, sepse lirisht mund të them se edhe programi i kësaj organizate është i ndërtuar mbi bazën e shpifjeve, e trillimeve, që absolutisht nuk mund as një fëmijë i shkollës fillore t'i besojë. Unë do t'i kisha sugjeruar që më mirë të merret me hartimin e një programi, apo një oferte çka i ofron qytetarit të Kosovës, mirëpo pasqyra më e mirë se kush janë dëshmon situata e krijuar në kryeqendrën Prishtinë pas marrjes së pushtetit, meqë e kanë bllokuar jetën dhe e kanë varfëruar dhe vështirësuar jetën e qytetarëve të vendit.

Absolutisht, më vjen shumë keq, se nuk e di ndonjë institucion apo mik i Kosovës që ka mbetur pa u përfolur e akuzuar me shpifje të llojllojshme. Ne i besojmë Bashkimit Evropian, i cili e demantoi një gjë të tillë. Ne besojmë fuqishëm, sepse e dimë që ato janë shpifje dhe trillime të njerëzve, të cilët vërtet nuk ia duan të mirën këtij vendi, por ne do të vazhdojmë të punojmë, të angazhohemi dhe qytetari i Kosovës është ai që me votën e tij dëshmon se kë e vlerëson, kë e përkrah dhe kush është vërtet duke i shërbyer mirëqenies së qytetarëve të vendit.

Prandaj, është vërtet e tepërt të merremi me këso lloj përrallash, me të cilat tash jemi mësuar, janë bërë rutinë t'i dëgjojnë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Haxhi Shala e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Në emër të Grupit është Enveri!

KRYETARI: Unë mendova në bazë të hierarkisë. Atëherë, Enver Hoti, në emër të Grupit Parlamentar "Nisma", e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Ka kohë që në jetën tonë politike, shoqërore e institucionale po ndodh një degradim që nuk i duhet askujt.

Degradimin e nivelit të lartë po e konfirmon edhe raporti konfidencial i hartuar nga një komision hetues i Komisionit Evropian. Ne si subjekt politik i kemi pasur vazhdimisht dyshimet tona, por tani kjo po vërtetohet pjesë-pjesë. Kjo e vërtetë është e hidhur dhe se askush s'e ka dëshiruar t'i shohë në këtë nivel as zyrtarët, e as institucionet e vendit. Ky raport me gjasë nuk ishte për publikun, por dikush e mori guximin qytetar, njerëzor dhe intelektual, për ta publikuar një të vërtetë të hidhur edhe për BE-në.

Çka duhet të themi ne pas këtij raporti, një pjesë e të cilit u bë publik. Ne duhet t'i falënderojmë njerëzit, të cilët patën guximin të zbulojnë, të rrënojnë një plan misterioz. Po si u krijua kjo marrëdhënie ndërmjet vendorëve dhe zyrtarëve të EULEX-it? Mendoj se nuk ka asnjë metodë tjetër, pos metodës së korrupsionit dhe komprometimit të vendorëve dhe të zyrtarëve të misionit të EULEX-it.

KRYETARI: Ju kisha lutur për qetësi, deputeti po flet! Ju lutem!

ENVER HOTI: Të nderuar deputetë, "Nisma" e mbështet vazhdimin për ta zbuluar dhe ndriçuar deri në fund këtë plan, i cili pa dyshim do ta shkatërronte jetën e njerëzve të pafajshme e, në anën tjetër, do të amnistojë ndonjë i fajshëm dhe kjo është për të të ardhur keq.

Por, në të njëjtën kohë jemi shumë të shqetësuar për këtë që po del nga këto raporte konfidenciale, sepse kjo tentativë tregon se në çfarë mase ka degraduar sistemi i drejtësisë dhe se sa e pasigurt është gjendja në vend, e veçmas e atyre të cilët guxojnë të ofrojnë koncepte e bindje tjera politike e qeverisëse.

E keqja më e madhe është se qytetarët tanë dita-ditës po e humbin besimin dhe shpresën në ata që i pritën si çlirimtarë dhe si perspektiva e vendit, por tani po i përcjellin si të korruptuar dhe pa parim, duke konsideruar si uzurpatorë të shtetit dhe pasurisë publike e kombëtare. Kjo është e dhimbshme, në mënyrë të veçantë për shumë bashkëluftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët punuan aq shumë për t'i sjellë në pushtet këta njerëz për punë dhe veprime krejtësisht tjera.

Shtrohet pyetja se si u gjetën në valë të njëjta drejtues dhe ekspertë të EULEX-it, pra njerëz që kishin ardhur për të sjellë dhe vendosur standarde evropiane në sistemin tonë të drejtësisë? Me siguri këtu kjo ka ndodhur për pushtet dhe për shumë para në këtë lojë të papastër. E papranueshme është edhe heshtja e zyrtarëve të BE-së, e pse jo edhe të SHBA-së, të cilët nuk kanë hezitur të reagojnë edhe për çështje tepër minore në krahasim me këtë të keqe.

Singerisht, nuk mund ta kuptoj as heshtjen e akullt të kryeministrit, i cili është futur në një heshtje tërësisht të ftohtë dhe sikur të jetë i pashpresë edhe vetë ai. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Janë dy deputetë pa grup parlamentar, duhet zgjedhur ndërmjet njërit, Margarita ose Gëzimi. Cili e keni më me urgjencë? Për përparësi, Gëzim dhënë Margaritës. Urdhëro pra, Margaritë!

MARGARITA KADRIU-UKELLI: I nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në Kosovën tonë të vogël, as 11 mijë km katror, s'po kalon asnjë javë pa shpërthyer ndonjë skandal, e që zakonisht po lidhet me mungesën e sundimit të ligjit. Në mesin e skandaleve të panumërta që po shpërthejnë në publik është njëri për të cilin qytetarët janë goxha të brengosur dhe të shqetësuar dhe në vazhdimësi po më kontaktojnë për ta ngrehur këtë çështje edhe në Kuvendin e Kosovës.

Organizata Botërore e Shëndetësisë me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit, që shënohet çdo vit, sivjet ia dedikoi vëmendjen sigurisë së ushqimit, për të cilin po flitet shumë, sidomos kohëve të fundit. Si pasojë e mosfunksionimit normal të institucioneve kompetente të shtetit, në tregun tonë qarkullojnë prej vitesh gjithfarë produktesh ushqimore pa u mirëkontrolluar as në hyrje, as në shpërndarje, shitje, apo konsumim. Agjencitë përkatëse shtetërore që bëhen se kinse bëjnë kontrollin e ushqimeve janë tepër jotransparente dhe sidomos të papërgjegjshme kur është fjala për të publikuar të dhëna, të cilat lidhen me interesat klienteliste dhe monopoliste të shoqërive të caktuara tregtare, që falë lidhjeve, po e theksoj korruptive, me zyrtarë të caktuar të shtetit bëjnë çfarë të duan, duke e rrezikuar seriozisht shëndetin e gjithë qytetarëve të Kosovës.

Ndërkohë, ata që e pësojnë gjithmonë janë qytetarët e këtij vendi, të cilët ndihen të pasigurt për shkak të mungesës së kontrollit dhe moszbatimit të ligjshmërisë. Çfarë garancish jep shteti ynë për të mos lejuar depërtimin në treg të produkteve të rrezikshme për shëndetin? Për shkak të krimit ekonomik me dhe për motive korruptive, që ka përfshirë edhe segmente shtetërore, siguria e ushqimit aktualisht është bërë më e dobët se asnjëherë më parë.

Se cilësia e importeve për ushqim human nga jashtë nuk mirëkontrollohet, flet shumë qartë edhe raporti i Komisionit për Bujqësi, ku shihet qartë se ligji nuk po zbatohet dhe popullata definitivisht nuk është e mbrojtur nga produktet ushqimore të dyshimta. Duke favorizuar dallaveret me lëndët dhe mallrat e importuara, siç ka ndodhur kryesisht me grurin për kafshë, apo me qumështin pluhur nga Serbia, kjo pasiguri, jo vetëm që po thellohet, por tanimë e ka rrezikuar seriozisht shëndetin e qytetarëve.

Ndërsa, në anën tjetër, po dëmtohen dhe demotivohen prodhuesit vendorë të produkteve bujqësore në vend. T'u ofrohen qytetarëve krunde për miell, si dhe qumësht pluhur me afat të skaduar nga importi në vend të qumështit vendor të kafshëve dhe në vend se të mbrohet dhe stimulohet prodhimi vendor i grurit dhe i qumështit, kjo me të vërtetë është e tepruar.

Të nderuar deputetë dhe Kabinet qeveritar,
Këtij abuzimi me ligjin dhe me shëndetin e qytetarëve duhet t'i thuhet stop dhe atë që nga kryeministri e Qeveria, por njëkohësisht edhe nga Prokuroria e Shtetit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Emilija Rexhepi, nga Partia Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala, predsedniče Parlamenta!
Poštovani predstavnici Vladinog Kabineta,
Kolege poslanici,
Poštovani i uvaženi ministri Obrazovanja gospodine Bajrami!

U ime Bošnjake zajednice zahtevamo od Vas institucionalnu podršku otvaranju ekonomsko smeru na bosanskome jeziku, pri javnim Univerzitetu "Ukshin Hoti" u Prizrenu, po istom sistemu nastave, odnosno kurikulumu Ministarstva Obrazovanja Republike Kosovo na albanskom jeziku.

Poštovani ministre, tim stručnih ludije naišao je na razumevanje rektora, gospodina Rame Vataj, daje upustva svojim saradnicima da se odmah krene sa tehničkim pripremama, kako bi nastava na pomenutom fakultetu započela tokom ove godine. Imena stručnih kadrova sa celokupnom popratnom dokumentacijom dostavljena je Sekretaru univerziteta, imamo podršku i od dekana na Ekonomskom fakultetu u Prizrenu. Potrebna je samo i vaša pomoć, kako bismo završili ovaj proces u pozitivnom smislu, s obzirom da je vizija javnog univerziteta otvaranje novih atraktivnih smerova u zavisnosti od tržišta i potrebe rada a bošnjački studenti, znate i sami ministre, da imaju veliki problem oko nostrifikacije diploma, molimo vas da vam ovo bude prioritet za jedan multietnički grad kakav je Prizren a smatram i da vizija tog javnog univerzitete Ukshin Hoti bio je i otvaranje novih međuetničkih smerova i poštovanje jezika službenih na lokalnom nivou, kakav je turski i bosanski jezik. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Ismail Kurteshi, nga Lëvizja "Vetëvendosje".

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit!

Së pari, nëse ato që i vlerësuat si, dikush poezi, e tjetri përralla, mandej edhe gënjeshtër, janë të atilla, atëherë është mirë që të shkoni dhe këtë raport të EULEX-it ta çoni në Prokurori, e jo të merreni këtu me cilësime, të cilat nuk u kanë hije deputetëve.

Deputetë dhe qytetarë të nderuar të Kosovës,

Përpyekjet për çlirimin e Kosovës nga ish-Jugosllavia, gjegjësisht Serbia, kanë filluar herët. Këto përpjekje për liri janë përcjell me sakrifica të llojllojshme. Përpyekjet për liri kanë prodhuar dëshmorë të kombit në periudha të ndryshme.

Familjet e dëshmorëve të rënë para vitit 1999, përveçse kanë mbetur pa më të dashurit e tyre, ato familje janë përballur edhe me trajtim çnjerëzor të pushtetit okupues serb. Këto familje të keqtrajtuara nga okupatori dikur, po diskriminohen edhe tani nga Qeveria e Kosovës, e cila po refuzon ta zbatojë ligjin, i cili u garanton këtyre familjeve të drejta të barabarta me familjet e dëshmorëve të luftës së fundit.

Në nenin 8 të ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, në lidhje me të drejtat në pension dhe beneficione të tjera për anëtarët e familjeve të ngushta të dëshmorëve, përveç tjerash parasheh:

- Të drejtën në pensionim familjar;
- Të drejtën për përparësi në punësim në kushte të barabarta;
- Të drejtën për përparësi në regjistrim dhe pranim në institucionet arsimore, publike, në kushte të barabarta me të tjerët;
- Bursë për shkollim të mesëm dhe universitar;
- Vendosje në konvikt të studentëve pa kompensim;
- Përkujdesje për strehim familjar dhe disa beneficione të tjera, të cilat edhe i meritojnë këto familje.

Në pikën 2 të nenit 8 të të njëjtit ligj thuhet: “Këto të drejta i realizojnë edhe të gjitha familjet e dëshmorëve të kombit, të rënë në forma të ndryshme për lirinë e vendit, në periudha të ndryshme historike. Mirëpo, këto të drejta të garantuara me ligj nuk i gëzojnë rreth 150 familje të dëshmorëve, që kanë rënë para vitit 1998.

Moszbatimi i këtij ligji për këto familje të vuajtura e të persekutuar për dekada me radhë nuk paraqet vetëm shkelje ligjore, por edhe degradim moral të të gjitha qeverive të pas pavarësisë së Kosovës.

Prandaj, kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që menjëherë të fillojë zbatimin e këtij ligji, që i barazon këto familje të dëshmuara të dëshmorëve të kombit, me familjet e dëshmorëve të rënë gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në fakt, kemi edhe 6 diskutues. Albini do ta marrë fjalën gjithsesi, po edhe pesë të tjerë... dëgjo, ose duhet pasur një konsensus të përbashkët për të vazhduar, ose me duhet ta ndal.

Teutë, në qoftë se këta pajtohen, edhe ti merre fjalën. Edhe Teuta, tash të kemi mirëkuptim! Pastaj, të gjitha mbeten për seancën e radhës. Kërkoj falje! Edhe ti Albin, përgatitesh, vetëm sa më shkurt të lutem!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Unë sot po e ngre një shqetësim të mësimdhënësve të Republikës së Kosovës.

Përkundër që u mashtruan nga ish-kryeministri Hashim Thaçi për rritje pagash, ata po vazhdojnë të mashtrohen sot fshehurazi nga kryeministri Isa Mustafa.

Kisha dashur të jetë kryeministri këtu, për të parë se shifrat gjithherë flasin dhe, ai po mundohet si ekonomist, me të vërtetë t'i mashtrojë shumë thjeshtë, të gjithë mësimdhënësit.

Më lejoni, ju lutem, që t'i tërheq dy paralele. Pagën e mësimdhënësve që e kanë marrë në muajin mars dhe pagën e mësimdhënësve që e kanë marrë në muajin janar. Pra, paga e një mësimdhënësi në muajin mars bruto 480,17 euro, pensioni 24,01, tatimi 23,42 euro dhe neto 430,58 euro. Po t'i mbledhim të gjitha këto, pra normal se japin, si ekonomist duhet ta dijë, japin pagën bruto.

Tani po ju tregoj se si ndodh sot dhe si mashtrohen sot mësimdhënësit në muajin maj duke mos llogaritur, duke i mashtruar që po u llogaritet përvoja e punës dhe pagesa, përkundër shifrave që shkruajnë në formularin që ata nënshkruajnë, ata mashtrohen dhe vetëm një mësimdhënësit i merret nga buxheti i tij 71,22 euro.

Ja, po ua argumentoj. Paga bruto 534,20 euro dhe tani pensioni 26,71 euro, 28,55 tatimi, vitet e shërbimit 35 vjet, që i bie se duhet t'i marrë 70,88 euro, nga sindikata që paguajnë 2,39 cent, paga neto 476,55. Kur i mbledhim të gjitha këto e japin vlerën 605,42 euro, kurse mësimdhënësi në fjalë, njëri nga ta, ka marrë 534 euro. Kur i zbresim 605,42 euro pra shumë prej 534,20 centë del që 71,22 centë i janë vjedhur, thjeshtë, nga Qeveria e në këtë rast nga i pari i Qeverisë, i cili i mashtroi se po ua paguan, pra përvojën e punës.

Këto janë mashtrime të radhës, përkundër që u mashtruan dhe u tha haptazi që nuk do të ketë rritje të pagave, ngase u mashtruan nga ish-kryeministri Thaçi, tani po mashtrohen me letra nga ekonomisti, pra në këtë rast, nga kryeministri i Kosovës, zoti Isa Mustafa.

Shqetësim i tyre i dytë është edhe kontrata e punës, të cilët edhe këtë vit e nënshkruan si kontratë njëvjeçare, ata po maltretohen. Këtë premtim e kam marrë dje në Komision nga ministri i Arsimit, që nga viti i ardhshëm ata nuk do të maltretohen, pra gjithnjë...

KRYETARI: Deputete faleminderit, por kur kërkon... unë po e thyej Rregulloren, po kërkon fjalë, mbi 20 herë ke përdorur fjalë fyese. Edhe pak për respekt, lëreni... mashtrues, mashtrues... e rëndë. Po, pavarësisht, thuaj ndryshe, si "s'e ka folur të vërtetën"... , por kjo shumë e rëndë.

Realisht tash më duhet... thyerje pas thyerje, ministrja e bën një reagim për korrektësinë e numrave.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI : Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Zonja Haxhiu, nëse kurrëgjë tjetër, e ke dëshmuar se je një matematikane e mirë.

Mirëpo, kur flasim me numra duhet treguar realitetin, se për t'i matur numrat dhe përqindjet është shumë lehtë, përdorim një kalkulator dhe nxjerrim përqindjet dhe varet qysh duam t'i nxjerrim rezultatet. Por, është mirë faktikisht të dihet për të gjithë qytetarët, që pagat për muajin e kaluar, domethënë pagat e muajit maj kanë dalë me rritje, është paguar përvoja e punës. Më besoni ose jo, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ka person, të cilit ju ka njohur 42 vjet përvojë pune dhe paga e tij është rritur 309 euro. Në mesatare, pagat e të gjithë shërbyesve civilë në Kosovë janë rritur për 6%, kostoja e kësaj rritjeje ka qenë 2,5 milionë, me shifra të sakta nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Ju lutem shumë, ju si mësimdhënëse e dini shumë mirë gjendjen e arsimit, ne e kemi edhe ministrin e Arsimit, këtu- ndoshta, po ndërhyj në kompetencat e tij, kur flasim për rritje pagash, është mirë shumë, që të kërkohet edhe nga personeli arsimor dhe nga të gjithë të tjerët, që ta ngrenë performansën, të paktën në këtë përqindje që atyre u rriten pagat, sepse ju si mësimdhënëse, para së gjithash, e keni për obligim të kërkonit kualitet për fëmijët tanë, që ulen në bankat shkollore, para se të kërkonit rritje të pagave. Pagat janë ngritur prej paslufte disa herë, mirëpo kualiteti i arsimit nuk është ngritur dhe besoj, që edhe prej Qeverisë tonë edhe prej ministrit të Arsimit, ka ardhur koha që prej të gjithë shërbyesve civilë, të cilët sot i kanë pagat më të mira se në sektorin privat, të kërkohet ngritje e performansës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po deputete, unë e di se ti e ke një shqetësim për shkak të deputetëve, por prej muajit të ardhshëm po na u rritkan edhe neve. Po, mjaft të mëdha i kemi. Deputete, të lutem, se po e prishim krejt seancën.

Regjia, të lutem shumë shkurt, 30 sekonda.

TETUA HAXHIU: Shumë shkurt! Kryetar, faleminderit!

Profesoreshë e nderuar, edhe ju jeni profesoreshë, e di shumë mirë dhe performansë është mirë të matet për secilin. Megjithatë, po flas me argumente.

Të lutem, me emër e mbiemër, vetëm një rast që e kam marrë. Verifikoje, në qoftë se nuk është kështu, nuk i paguhen vitet për shërbim, 35 vjet nuk i paguhen. Mos i mashtroni mësimdhënësit, i keni me argumente, të lutem. Po, e kam marrë vetëm një rast, i keni për të gjithë mësimdhënësit.

KRYETARI: Faleminderit! Albin Kurti e ka fjalën jashtë Rregullores.

ALBIN KURTI: Reagimi me nervozë i këtyre dy protagonistëve të aferës “Pronto” Veseli dhe Grabovci ndaj fjalimit tim, tregon që ka shumë të vërteta në atë raport konfidencial të EULEX-it.

Ne të gjithë e mbajmë mend atë pjesën e famshme të fjalisë së bashkëbisedimit të tyre në aferën “Pronto”, “kesh atje në Bruksel, i takova ata bosët...”.

Pra, bëhet fjalë për po këta dy protagonistë, të cilët u bënë shumë nervozë nga fjalimi im dhe në njëfarë mënyre dëshmuar, që ai është i vërtetë. Cinizmi i zotit Veselit është dashakeq. Pra, cili është kuptimi që ai fjalimin tim e quan poezi. Në njërën anë, unë nuk e konsideroj veten të zotin për poezi dhe kjo tregon, se ai ose nuk e vlerëson, ose nuk e kupton poezinë, mirëpo, në anën tjetër, ai tregon se është një njeri dashakeq, e keqpërdor ulësen ku është instaluar si kryetar Kuvendi, që të më përgjigjet me cinizëm prej atje për një çështje shumë serioze.

Ne e kemi alternativën qeverisëse të “Vetëvendosjes” ajo i ka 20 kapituj dhe 3 shtylla dhe ky është programi ynë, zoti Grabovci. Nëse jeni të interesuar, unë mund t’ua dhuroj një kopje, por leximin duhet ta bëni vetë. Dhe së fundi, në komunën e Prishtinës nuk ka fëmijë të uritur në shkolla fillore, nuk ka fëmijë pa kontroll shëndetësor dhe nuk ka ndërtime pa leje. Ndryshimi i Prishtinës për të mirë gjithsesi, për interesin e përgjithshëm vazhdon. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kurti, për këto përralla. Megjithatë, vazhdojmë me seancën. Realisht, presim konfirmim zyrtar, pastaj do të reagojmë zyrtarisht, por, mbi diçka të paqenë, jo se s’merret seriozisht, po nuk mund ta kesh. Vazhdojmë!

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjatë 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 15 pyetje parlamentare. Nezir Çoçaj ka pyetje për ministrin Arsim Bajrami, përgatitet deputetja Labinotë Demi-Murtezi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në Kosovë edukimi parashkollor është pjesë e Ministrisë së Arsimit. Kjo Ministri dhe mbështetësit e saj viteve të fundit kanë punuar në përmirësimin e infrastrukturës ligjore profesionale në përgatitjen dhe zhvillimin profesional të edukatorëve.

Siç dihet, edukimi parashkollor organizohet në institucione publike, private, në klasa para fillore dhe në qendra me bazë në komunitet, por numri i fëmijëve të përfshirë në këtë nivel edukimi është shumë i vogël në krahasim me shtetet tjera, si dhe me kërkesat e fëmijëve për t’u regjistruar në edukimin parashkollor. Po ashtu, te ne ka komuna që fare nuk kanë institucione publike parashkollore apo shumë nga komunat kanë vetëm nga një institucion të tillë publik.

I nderuar ministër,

Në programin qeveritar është paraparë që të ketë vizita të rregullta mjekësore në familjet e fëmijëve 0 deri në 3 vjeç, siguri të hapësirave të mjaftueshme duke adaptuar shtëpitë ekzistuese nëpër fshatra apo lagje të qyteteve, punësim të një numri të konsiderueshëm të edukatorëve e tjerë.

Po ashtu, nëse i referohemi edhe raportit të Universitetit... të përgatitur nga UNICEF-i në vitin 2012 dhe studimet e fundit të cilat janë bërë për zhvillimin e fëmijërisë së hershme në Kosovë, tregojnë se ky nivel edukimi duhet të zhvillohet në tri komponentë, bashkërisht, siç janë:

shëndeti, edukimi dhe mirëqenia e fëmijëve, pra duke u mbështetur në zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve.

Të njëjtin konstatim e nxjerrin edhe konkluzionet e Këshillit të Evropës, të qershorit të vitit 2011 dhe po ashtu e kemi edhe nobelistin James...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Para se të përgjigjem në pyetjen e deputetit, i njoftoj të gjithë deputetët se tani krahas përgjigjeve me gojë secili prej juve do të marrë edhe përgjigjen me shkrim në e-mail-in tuaj zyrtar dhe jeni të lirë për të më kontaktuar drejtpërdrejt për pyetje shtesë në mënyrë që t'ju mbaj të informuar për të gjitha çështjet që ju i shtroni. Kështu që nga sot, krahas përgjigjes me gojë do t'i keni edhe përgjigjet me shkrim.

Do të doja vetëm një fjali për diskutimin e zonjës Haxhiu. Do të doja që në këtë Parlament të diskutojmë sa më shumë për ngritjen e cilësisë dhe të mos diskutojmë gjithmonë vetëm për pagat, sepse pagat e arsimtarëve tani janë dinjitoze. Nuk janë më të mirat, por janë dinjitoze dhe kemi nevojë në këtë Parlament të bëjmë debate për ngritjen e cilësisë në të gjithë sektorët e arsimit. Nuk ka nevojë të bëhemi avokatë të një mësuesi, sepse kemi 29 mijë mësues dhe unë sot i kam pritur sindikatat në mëngjes para takimit dhe ata kanë shprehur kënaqësi me faktin që tani paga mesatare e mësuesit kalon 500 euro, është një pagë më e mirë se sa e shërbyesve në administratë publike, por kemi nevojë që këto paga t'i meritojmë komplet në sektorin e arsimit me ngritjen e cilësisë.

I nderuar deputet Çoçaj,

Faleminderit për dy pyetje shumë të rëndësishme dhe më lejo të jap përgjigjet në këto pyetje të shtruara.

Përfshirja e fëmijëve tanë në fëmijëri të hershme në sistemin edukativ është një prioritet i Qeverisë së Kosovës dhe është një prioritet i shtetit tonë dhe ne jemi duke bërë plane për përfshirjen nga pika 0, nga mosha 0 deri te pika 6 vjeçare dhe kemi ndarë në dy grupe. Grup-moshat nga 0 deri në 3 vjeçar përfshihen në sistemin parashkollor, kurse për grup-moshat prej 3 deri në 5 vjeçar jemi në përgatitje të kurrikulës.

Gjithashtu jemi duke diskutuar me partnerë që klasën e parë para filllore, fëmijët prej moshës 5 deri 6 ta bëjmë si kategori të detyrueshme të shkojnë në shkolla për t'u përgatitur për klasën e parë.

Deri më tani kemi 43 çerdhe publike të licencuara dhe kemi 50 çerdhe private të licencuara, që përfshijnë gjithsej 77 mijë nxënës. Jemi duke punuar për rritjen e këtyre çerdheve. Në mënyrë të veçantë do të investojmë tek çerdhet publike dhe jemi duke punuar për përgatitjen e mësimitdhënësve për kopshte, për mësimitdhënie të hershme dhe në partneritet me partnerët tanë, sidomos me CARITAS-in kemi nënshkruar një memorandum të madh për pajisjen e 150

çerdheve me pajisje moderne për një mësimdhënie argëtuese dhe jemi duke i trajnuar mësimdhënësit në këto çerdhe.

Në mënyrë të veçantë jemi duke punuar në procesin e licencimit të çerdheve private, ku dëshirojmë të kontrollojmë secilën çerdhe në kuptimin e plotësimit të standardeve në mënyrë që këto çerdhe asnjëherë të mos kenë motive biznesore, por gjithmonë të kenë edukative.

Natyrisht përfshirja e fëmijëve në çerdhe është pak edhe pjesë e kulturës familjare, pjesë e kulturës familjare dhe ne po punojmë që ajo kulturë të ngritët dhe secila familje fëmijët t'i dërgojë në çerdhe, kurse po punojmë bashkë me...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të lutem mos ia ndalni fjalën!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: ... dhe së shpejti do ta bëmë edhe në Parlament ndoshta një plotësim të projektligjit ku do ta bëjmë krahas arsimit fillor të detyrueshëm edhe klasën para fillore, pra fëmijët prej moshës 5 deri në 6 vjeçar, do ta bëjmë si pjesë të detyrueshme.

Pyetja e dytë që e ke bërë, jemi duke përgatitur strategjinë ndërministrore për shërbime të integruara në çerdhe, çka do të thotë – edhe shërbimet edukative, edhe shërbimet shëndetësore, edhe shërbimet e ofrimit të asistencës së pedagogut dhe psikologut, në mënyrë që këta fëmijë të kenë një strategji kombëtare të marrjes së një mësimi qysh në fëmijëri të hershme.

KRYETARI: Faleminderit! Lus regjinë që, qoftë deputeti, qoftë ministri kur përgjigjen, mos ia ndalni fjalën. Urdhëroni zonja deputete, pyetje për ministrin Arsim Bajrami. Zonja Demi, e ka fjalën.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit për fjalën, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Humbja e besimit të popullatës te mësimdhënësit po rritet. Kjo çështje paraqet një problem të madh që po vazhdon të rritet gjithnjë e më shumë.

Shumë mësimdhënës anekënd Kosovës po thyjnë rregullat e përcaktuara për mbajtjen e kurseve private në lëmi të ndryshme. Mësimdhënësi i lëndës së njëjtë të caktuar në një shkollë mban kurse me nxënësit e tij apo të saj me pagesë në mënyrë që nxënësi të përforcohet në lëminë gjegjëse.

Si është e mundur që i njëjti mësimdhënës nuk është i qartë sa duhet në shkollë, ndërsa shumë i qartë në kurset private?

I nderuar ministër Bajrami,

Cila është korrespondenca e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë me drejtoritë komunale të arsimit në gjithë komunat?

Cilat janë parakushtet që mundësojnë, përkatësisht kufizojnë mbajtjen e kurseve private?

A keni evidentuar, ose më mirë të themi a keni pezulluar ndonjë mësimdhënës për thyerjen e këtyre parakushteve? Faleminderit paraprakisht!

KRYETARI: Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit e nderuara deputete për pyetjen!

Më lejo të jap përgjigjen!

Siç e dini, arsimit para universitar është kompetencë e komunave dhe Ministria e Arsimit është në kontakte të drejtpërdrejta me drejtoritë komunale të arsimit dhe në çdo takim që kemi muajor në tërheqim vërejtjen për këtë dukuri që është edhe çështje e etikës pedagogjike dhe profesionale. Është e vërtetë se në brenda shkollave publike organizojmë dy lloj mësimi, mësimin shtesë dhe mësimin plotësues, organizojmë orë shtesë për nxënës me sukses të dobët dhe organizojmë edhe mësimin plotësues për talentet e veçantë, të cilëve edhe u japim edhe orë shtesë por të gjitha këto bëhen me shërbime pa pagesë brenda shkollave publike.

Jo rrallë Inspektorati i Arsimit ka pasur informata të tilla dhe ne kemi kërkuar që vërtet drejtoritë komunale të jenë vigjilente dhe të mos lejojnë ofrimin e kurseve private nëpër shtëpi private. Së shpejti do të përgatisim një udhëzim administrativ në nivel të Ministrisë me të cilin do të penalizojmë apo do të ndëshkojmë secilin mësimdhënës i cili ofron kurse private me pagesë për nxënës nëpër shtëpia private dhe pastaj njësi e Inspektoratit nëpërmjet një inspektori të specializuar do të monitorojë.

I ftoj të gjithë prindërit që t'i denoncojnë këto raste dhe ftoj të gjithë prindërit që mos t'i çojnë fëmijët në kurse private nëpër shtëpi private por të kërkojnë nga drejtorët e shkollës organizimin e orëve shtesë dhe mësimin plotësues sepse drejtorët e shkollës janë të obliguar që brenda shkollës publike të ofrojnë orë shtesë për nxënësit që kanë nevojë për mësimdhënie.

Në mënyrë të veçantë kërkoj nga mësimdhënësit që të mos ndjekin kurse private tani në prag të maturës, por të kërkojnë vërtet trajnime dhe kurse që i ofron shkolla publike.

KRYETARI: Faleminderit zoti ministër! Në qoftë se do të më lejoni, duke vazhduar në këtë pikë, do të bëja vetëm një njoftim.

Së bashku me kolegët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare, kemi vendosur që me datën 9 qershor 2015, në orën 12:00 të kemi seancë solemne për heroin e kombit, Isa Boletini, gjersa nga ora 13:00 do të kemi edhe homazhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Edhe një herë, ministri po na thotë se mund të vonohen, për arsye se është lëvizja nëpër komuna, që do të thotë homazhi të jetë në orën 14:00.

Pra, edhe një herë. Në orën 12:00 e kemi seancën solemne këtu, e pastaj në orën 14:00 do t'i kemi homazhet në hollin e Kuvendit. Homazhet do të jenë për deputetët e Kuvendit, dhe të keni parasysh, do të jenë edhe për qytetarët nëse dëshirojnë, kanë të drejtë të futen e t'i bëjnë homazh heroit tonë kombëtar.

Vazhdojmë me pyetjen nga deputeti Pal Lekaj, për ministren Hykmete Bajrami.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2014 ka vlerësuar se deklarimi i tri zonave të reja ekonomike, duke e përfshirë edhe atë të Gjakovës, janë bërë pa planin e duhur nacional dhe më shumë në bazën ad hoc.

Ne jemi të vetëdijshëm se këto zona janë të një rëndësie të veçantë, por që nga premtimi, asgjë tjetër nuk është bërë në këtë drejtim.

E nderuar ministre,

Çka po ndodh me këtë proces për krijimin e këtyre zonave që janë me rëndësi të veçantë?

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, zonja ministre!

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Faleminderit për pyetjen zoti Lekaj!

Është e vërtetë se në mars të vitit 2013 është aprovuar Ligji për zonat ekonomike, ligji numër 04/L-159 në të cilin parashihet krijimi i zonave ekonomike si dhe formimi i Këshillit Kombëtar për hartimin e planit kombëtar të zonave ekonomike.

Bazuar në këtë ligj, është formuar Këshilli Kombëtar i cili ka hartuar paraprakisht koncept - planin kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë i cili është aprovuar në mbledhjen e 153-të të Qeverisë, vendimi numër 04/153 i datës 25 tetor 2013, ku ndër të tjera, ky koncept plan kombëtar për zhvillimin e zonave parasheh edhe krijimin e zonave të lira ekonomike.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e vet të 178-të të mbajtur me datë 18 mars 2014 bazuar në këtë koncept plan, ka vendosur krijimin e zonave ekonomike kadastrale në Mitrovicë, me vendimin 03/178, mandej në të njëjtën mbledhje merret vendim që të formohet edhe zona e lirë ekonomike në zonën kadastrale të Gjakovës me vendimin 02/178 dhe së fundmi, në mbledhjen e 180-të të Qeverisë, me datën 28 mars 2014, është marrë vendimi 01/180 ku krijohet zona e lirë ekonomike kadastrale në Prizren.

Sa i përket politikave dhe orientimeve të Qeverisë Mustafa, është e vërtetë se për hartimin dhe themelimin e këtyre zonave ekonomike nuk janë bërë studimet e fizibilitetit, por ajo çfarë mund të themi është se zonat ekonomike janë tepër të rëndësishme e në kuadër të tyre tepër të rëndësishme janë zonat industriale, parqet teknologjike në kubatorë të biznesit.

Këto tani, siç e dini, janë bërë pjesë e pakos së insentivave të cilat po ofrojnë vendet e rajonit dhe ne si Kosovë duhet t'i kemi në pakon tonë të insentivave, qoftë për shtyrje të investimeve të brendshme ose për tërheqje të investimeve të huaja, me qëllim për të qenë konkurrues.

Megjithatë, sa i përket asaj për krijimin e zonave të lira ekonomike, në aspektin e lirit nga tatimet, unë besoj se tani me pakon e re fiskale si zonë e lirë ekonomike mund të konsiderohet i tërë territori i Republikës së Kosovës, për arsye se me Ligjin për TVSH kemi lirim të lëndës së parë dhe makinerisë. Me Projektligjin që e keni për taksën doganore, prapë lirohet e gjithë lënda e parë e cila nuk prodhohet në Kosovë dhe lirohet makineria, me Ligjin për korporatat për tatimin në fitim është paraparë që të ketë pushime tatimore për të cilat ndërmarrjet që bëjnë investime dhe që krijojnë vende të reja të punës, andaj, në aspektin fiskal, i gjithë vendi ynë është një zonë e lirë ekonomike.

Sa i përket asaj se sa është bërë...

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Nëse ka mundësi, pak më shpejt!

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Unë mund të ju them se në zonën ekonomike të Mitrovicës, në vitin e kaluar, edhe pse Ministria i ka ndarë 200 mijë euro për financimin e infrastrukturës atje, nga kuvendi komunal janë shpenzuar vetëm 126 mijë dhe të tjerat janë kthyer në suficit.

Ne kemi një marrëveshje bashkëfinancimi me këtë komunë dhe janë ndarë edhe 200 mijë euro të tjera nga Ministria dhe tani komuna e Mitrovicës është në procedura të prokurimit për vazhdimin e infrastrukturës. Sa po të pajiset me infrastrukturë, ajo zonë do të fillojë edhe vendosjen e bizneseve.

Dhe sa i përket zonës ekonomike në Gjakovë këtu është bërë studimi i fizibilitetit mirëpo është duke u punuar në definimin e pronës. Dhe sa po të definohet prona, ne llogarisim që të ndajmë mjete për vitin 2016 për këtë komunë.

E njëjtë është gjendja në komunën e Prizrenit, ku edhe atje sapo të bëhet licencimi i zonës ekonomike nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministria do të planifikojë investime kapitale në ofrimin e infrastrukturës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Lekaj, keni pyetje? Nuk ka! Faleminderit!
Deputeti Pal Lekaj, pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin e jashtëm Hashim Thaçi.

Zëvendëskryeministri nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen? Nuk do të bëjë pyetje, e lë për tjetër herë.

Deputeti Faton Topalli, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!
Shpresoj që qytetarët e Kosovës ta kanë vërejtur që kryeministri i Kosovës, ministri i Punëve të Jashtme dhe ministri i Punëve të Brendshme nuk u përgjigjen asnjëherë pyetjeve të deputetëve.

Ky pohim nuk është përjashtim, është rregull që ndodh në Kuvend. Sinjali që japin drejtuesit e tri shtyllave kryesore të shtetit është që ne nuk ua varim deputetëve. Kjo...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Veç një moment, për komentet e patëm rubrikë tjetër. Të lutem shumë, nëse ke pyetje mund ta bësh ose s'e bën, si të duash.

FATON TOPALLI: Unë jam duke e bërë pyetjen.

KRYESUESI: Jo, je duke komentuar, s'je duke bërë pyetje. Pyetja është...

FATON TOPALLI: Jam duke e bërë pyetjen, por ju nuk po më lini kohë.

KRYESUESI: Urdhëro, bëje pyetjen!

FATON TOPALLI: Pra, sinjalin që japin kryeministri me mospjesëmarrjen e tij në këtë Kuvend është se ne nuk ua varim fare deputetëve dhe kjo nuk është hera e parë, kjo është po ndodh disa herë që në Kuvend kryeministri, ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Punëve të Brendshme deri më tash nuk u janë përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Me fjalë të tjera, kur i shohin qytetarët që ky nuk u përgjigjet as deputetëve, pra kjo nuk ua var as qytetarëve. Kjo është një sjellje jashtëzakonisht pa përgjegjësi e ministrave, e kryeministrit dhe e ministrit të Punëve të Jashtme.

Unë pyetjen time konkrete do ta shtroj kur kryeministri të jetë këtu. Është hera e dytë që po kërkoj që ta shtroj pyetjen, e kryeministri nuk vjen këtu, ministri i Punëve të Brendshme nuk vjen këtu, ministri i Punëve të Jashtme nuk vjen këtu, kjo është shumë pa përgjegjësi. Kaq!

KRYESUESI: Zoti koleg dhe deputet, Këtu është bërë pak edhe modë që s'duhet të bëhet. Ekziston një Rregullore e Kuvendit, as unë si prijës në këtë moment i kësaj seance, por as kryetari i Kuvendit nuk është mirë ta shkelë Rregulloren. Kjo po i bie që 'hajt se po e shkelim'. S'duhet ta shkelim hiç. Dihet sa minuta bëhet pyetja, sa jepet përgjigja dhe shtesa. Është shumë më e dobishme që të japim argumente se sa të mbajmë fjalime. Kjo vlen edhe për deputetët, vlen edhe për ministrat, sepse e kanë një rubrikë para kësaj, një gjysmë ore mund të deklarojnë programe, çfarë të duan, por ata nuk po flasin atëherë, por po mbajnë fjalime në përgjigje. Shkojmë tutje!

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për zëvendëskryeministrin Kujtim Shala.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër,

Më 29 janar të vitit 2014, në Artanë ka qenë takimi i parë për rivitalizimin e Kalasë së Artanës ndërmjet përfaqësuesve të Bashkimit Evropian, Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Komunës së Artanës dhe UNESCO-s.

Kjo e fund është duke bërë implementimin e projektit për Kalanë e Artanës me donacionet e Bashkimit Evropian.

Gjatë muajit qershor dhe korrik 2014 është kryer faza e parë e hapjeve dhe matjeve të mureve të kalasë nga kompania kroate “Omega-Inxhinjering” nga Dubrovniku, nga e cila është bërë edhe plani menaxhues për kalanë.

Punët e radhës për rivitalizimin e kalasë ju kanë dhënë jo rastësisht kompanisë “Koto” nga Beogradi. Kompania në fjalë ka kryer edhe më herët punë në territorin e Kosovës, saktësisht në kishat dhe manastiret ortodokse.

Zoti ministër,

Si e arsyetoni dhënien e punëve kompanisë nga Beogradi dhe pse ju si ministri nuk po i mbikëqyrni punët në këtë kala. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti deputet,

Projekti për Kalanë e Novobërdës mbështetet financiarisht nga fondet e BE-së - programi i instrumentit para asistencës, i njohur ndryshe si IPA.

Hartimi i projektit ka përfunduar vitin e kaluar, siç thatë edhe ju. Të gjitha procedurat i ka kryer Zyra e BE-së Prishtinë, edhe sa i përket hartimit të projektit, por edhe lidhur me zbatimin e punimeve, ndërsa projekti i është dhënë për zbatim UNESCO-s.

Për procesin e hartimit të projektit vitin e kaluar, Ministria e Kulturës, përkatësisht Instituti Arkeologjik i Kosovës ka pasur disa takime me përfaqësuesit e kompanisë “Omega-Inxhinjering”, që është një kompani kroate, dhe para fillimit kjo kompani është pajisur me leje pune në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Sa i pret zbatimin të projektit, ministria po pret që të dorëzohet projekti i zbatimit të punimeve dhe i njëjti duhet t’u nënshtrohet procedurave të shqyrtimit në përputhje me Ligjin për trashëgimin kulturore, ndërsa pas miratimit mund të fillojë zbatimi.

Me që kjo procedurë ende nuk është përmbyshur, ministria, përkatësisht Instituti Arkeologjik i Kosovës i ka ndërprerë punimet parapërgatitore. Punimet janë ndërprerë më 1 qershor 2015 dhe për këtë është njoftuar edhe Komuna e Novobërdës.

Zbatimi i projektit do të bëhet nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të Institutit Arkeologjik të Kosovës, pas trajtimit dhe miratimit të mundshëm të projektit. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputet Kurteshi, keni pyetje shtesë?

ISMAJL KURTESHI: Po, faleminderit!

Ministër, me sa jam i njoftuar, deri para disa ditësh, ministria juaj as që ka qenë e njoftuar për këto punime që po zhvillohen atje nga kompania në fjalë. Si është e mundur që këtu në territorin e Kosovës në objektet e trashëgimisë kulturore dhe të kulturës, në përgjithësi, dikush të marrë e

të angazhohet në punë pa u njoftuar ministria përkatëse, e cila dhe do të duhej, jo vetëm të njoftohej, por të japë leje për punë të këtilla?

KRYESUESI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI KUJTIM SHALA: Edhe një herë, aty s'po bëhen punime, nuk ka asnjë punim. Është ndërprerë faza parapërgatitore, që nënkupton matjet. Por, si procedurë, të gjithë e ka zhvilluar siç ju thashë Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, por në marrëveshje me Ministrinë e Kulturës në datat dhe në takimet për të cilat folët ju.

Edhe ajo që është fazë parapërgatitore është ndërprerë, meqë s'është miratuar projekti dhe s'mund të zbatohet. Është dhënë leja e punës, por s'është miratuar projekti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zafir Berisha, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

ZAFIR BERISHA: Meqë është pyetja e rëndësisë së veçantë, unë kisha pas qejf edhe për opinionin, edhe për ne deputetët, të jetë kryeministri. Pajtohem me zotin Topalli, në fakt unë do të shkoj pak më lart. Në rast se kryeministri vazhdon kështu të na injorojë, unë do të shkoj atje në Llapashticë në livadhe, ku është duke kositur, që t'ia bëj pyetjen se është e rëndësisë së veçantë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Valon Murati. Unë ia jap fjalën, por paraprakisht e kam një shkresë të Valon Muratit, i cili thotë se nuk do të jetë këtu dhe sugjeron që kjo pyetje është për ministrin e Mirëqenies Sociale, prandaj përgjigjen e jep ministri Abrashi. Urdhëro!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Unë i jam drejtuar ministrit të Diasporës, meqë çështja ka të bëjë edhe me ata njerëz që kanë kontribuar shumë nga Diaspora. Fjala është për 3 000 qytetarë të Kosovës që janë pensionuar në Zvicër, e nuk po mund t'i realizojnë pensionet e tyre për shkak të mospërmbushjes së obligimeve nga Qeveria e Kosovës.

Për këtë çështje Kuvendi e ka nxjerrë një rezolutë para pesë vjetëve. Unë e kam pyet ministrin Abrashi para tre muajve, e ai atëherë ka thënë se çështjet po lëvizin, por në ndërkohë këta qytetarë të cilët kanë halle janë interesuar të marrin përgjigje në ministri, e nuk kanë marrë asnjë përgjigje, mandej as që janë pranuar nga ministri Abrashi. Atëherë është mirë që ministri, meqë e ka marrë përsipër të përgjigjet në këtë pyetje, të na thotë se çka ka ndërmarrë gjatë këtyre tre muajve të fundit, në mënyrë që kjo e drejtë legjitime e këtyre pensionistëve të realizohet sa më shpejt.

KRYESUESI: Ministër Abrashi, urdhëro!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar ministra,
Deputetë,

Çështje e pensioneve të bashkatdhetarëve tanë, si në Zvicër, por edhe në shtetet tjera, posaçërisht në Austri dhe Gjermani, është trajtuar me seriozitetin më të lartë me marrjen e detyrës dhe për këtë kam raportuar edhe në Kuvend disa herë, por edhe në media disa herë.

Për ta pasur një sqarim më të qartë është edhe sqarimi për të gjithë deputetët e vërteta është se asnjëherë nuk është refuzuar asnjëri nga bashkatdhetarët tanë që jetojnë jashtë dhe kanë kërkuar informata. Realisht, ata e kanë derën hapur, edhe te unë direkt, edhe te pjesa e Kabinetit tim. Sidoqoftë, të kthehem në temë.

Ashtu siç është njoftuar Kuvendi edhe më herët, ne e kemi marrë pyetësin e dytë pas insistimit tonë në Ambasadën e Zvicrës dhe e kemi pranuar nga Ministria e Jashtme pyetësin e dytë në muajin shkurt. Në muajin shkurt është formuar një grup punues, i cili përfshin pjesët e Kabinetit tim dhe të ministrive tjera relevante që preken dhe kanë të bëjnë me pyetjet të cilat i ka kërkuar pala zvicerane.

Ne kemi punuar diku rreth dy muaj në atë pyetësor, pasi ka qenë shumë gjithëpërfshirës, e ka përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, agjencitë e ndryshme, dhe e kemi kthye pyetësin, në mos të gabofsha, pas përkthimit, diku në fund të muajit mars, dhe për këtë e kam njoftuar Kuvendin. Pas muajit mars, ne i kemi vazhduar kontaktet me shtetin e Zvicrës dhe prej këtyre kontakteve kanë rrjedhur dhe kërkesat tjera, të cilat ne kemi filluar t'i zbatojmë dhe për këto kërkesa të reja realisht nuk është njoftuar Kuvendi, pasi nuk ka pasur pyetje, por në media e di që e kam përmendur.

Ne kemi marrë obligim si ministri dhe e kemi fillua procesin e hartimit të marrëveshjeve të brendshme, një me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe si marrëveshje e tillë është në Zyrën Ligjore të dy ministrive. Ne presim që kjo të kalojë dhe kur ne si ministri të kemi qasje në regjistrin civil, pasi është një prej kërkesave, dhe tregon seriozitetin tonë.

Dhe e dyta marrëveshje është me bashkësitë fetare në Kosovë. Edhe këtu jemi duke i përgatitur marrëveshjet, e posa t'i kompletojmë këto dy marrëveshje, në dy sektorë, një me Ministrinë e Punëve të Brendshme, një me bashkësitë fetare të Kosovës, si të tilla ne do t'ia dërgojmë shtetit të Zvicrës dhe pastaj obligimet tona mbeten të përfunduara në një mënyrë.

Përpos kësaj, ne kemi marrë përsipër, si pjesë e këtyre marrëveshjeve me bashkësitë fetare, që t'i pajisim edhe zyrat e tyre me kompjuterë. Domethënë ka pak angazhime shtesë, ka pak kosto financiare, por ne se ministri e kemi marrë përsipër që t'i realizojmë të gjitha kërkesat që dalin prej shtetit të Zvicrës në mënyrë që të realizohen pensionet e bashkatdhetarëve tanë në Zvicër.

Me fjalë të tjera, jemi të përkushtuar me seriozitetin më të lartë. Obligimet tona që kërkohen do t'i përfundojmë në afat rekord. Tash marrëveshjet marrin kohë, Administrata, si te ne, si atje, merr kohë, përkthimet marrin kohë, implikimet ligjore apo lirimet nga këto obligime ligjore marrin kohë dhe duhet t'i respektojmë afatet, por besoni që jemi duke punuar në këtë drejtim dhe shpejt do të kemi edhe rezultate konkrete. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputet Kurteshi, ke pyetje plus?

ISMAJL KURTESHI: Zoti ministër!

Duke i pasur parasysh të gjitha afatet e parapara me ligj dhe duke i respektuar ato, na thoni ju lutem kur këta pensionistë konkretisht do t'i marrin pensionet? Cila është data, muaji së paku, ose viti, kur do t'i marrin pensionet?

Edhe një çështje tjetër: është shumë e vërtetë që pensionistët kanë ardhur në ministrinë tuaj dhe se dikush në ministri u ka thënë se po presin kot, se edhe një javë po të presin ministrin nuk e takoni dot. Vërtetohet kjo gjëra, e mos u qeshni dhe mos konstatoni që s'janë të vërteta gjërat për të cilat ju nuk jeni në gjendje t'i kontrolloni.

KRYESUESI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Dy çështje u ngritën. E para është që ne në afat rekord do t'i kryejmë obligimet tona. Pastaj mbetet në shtetin e Zvicrës që të vendosë. Domethënë, me dorëzimin e dy marrëveshjeve me bashkësitë fetare, edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme, ne kemi qasje në regjistrin civil që të bëjmë kontrollimin e çfarëdo kërkesë, ose emri që mund ta kërkojë shteti i Zvicrës. Ne një farë mënyre, 99% ose 100% do t'i kryejmë obligimet. Pastaj mbetet në vullnetin politik të shtetit të Zvicrës dhe lobimi për marrëveshje nënkupton që edhe unë vetë të lloboj, mendoj edhe ta vizitoj shtetin atje, por lobimi i secilit prej nesh është i domosdoshëm. Unë mund të them që ne do t'i kryejmë obligimet tona shumë shpejt, ndoshta brenda muajit, pastaj topi mbetet, siç themi, te shteti i Zvicrës.

Sa për mosqasje te ministri, ndoshta është mirë të kontrollohet ajo. Unë e ftoj këdo që e kanë kthyer prapa, kushdo që e ka kthyer prej zyrtarëve të ministrisë, janë 945 zyrtarë që punojnë në ministri, dhe dikush mund të thotë 'ministri nuk të pret', por ai nuk është pjesë e stafit tim. Stafit im për secilën kërkesë më njofton dhe nuk është e vërtetë që e kam kthyer dikë prej Zvicrës. Në qoftë se i ka thënë dikush në ndonjë komunë, të Dragashit a diku se s'të pret ministri, është problem i tij ku është drejtuar. Në zyrën time askush nuk guxon ta kthejë askënd pa i thënë unë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Çështja ka të bëjë me vendimet e marra nga Gjykata Themelore pa pëlqimin e qytetarëve, pra u ndalin shuma të caktuara në pensionin e moshës.

Pyetja për ministrin Abrashi është: Zoti ministër, a jeni në dijeni për ndalesat që po u bëjnë bankat në Kosovë, pra në bashkëpunim, ose me vendim të gjykatave themelore kësaj kategorie për borxhet e vjetra të energjisë elektrike, borxhe që kanë ndodhur të jenë, nga bisedat me ta, që i kam pasur janë parapagues të rregullt me vite të tëra, por që janë borxhe qysh nga paslufta. Faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: I nderuar kryesues,

Ministra, deputetë,

Gjithashtu ndalesat që po ua bëjnë qytetarëve të cilët janë përfitues të skemave të ndryshme të shtetit të Kosovës dhe për të cilët jam njoftuar edhe nga mediat, ka qenë diçka e papranueshme edhe për mua, sepse edhe pse nuk është e specifikuar diku me ligj, mendoj që Ligji i detyrimeve e prek këtë çështje dhe kam kërkuar nga Zyra Ligjore interpretim ligjor se si kjo duhet të ndërpritet, se mendoj që duhet ndërpritet. Edhe ata qytetarët të cilët marrin ndihma sociale, apo përfitojnë nga një skemë dhe kjo ka të bëjë me mirëqenien e tyre, është e pabazë dhe nuk ka kuptim që një komunë t'ua ndalë ato shuma në emër të mirëqenies dhe vetë jetesës për obligimet e ndryshme.

Ne kemi marrë angazhime, vetë Zyra Ligjore e ka filluar punën edhe me BQK-në, e ka filluar punë dhe kontaktet edhe me Ministrinë e Pushtetit Lokal që t'i gjejë alternativat më të mundshme që kjo të ndërpritet.

Besoj që gjatë javëve në vijim do të dalim me diçka konkrete dhe publike dhe do të kërkojmë nga ministria t'i shfuqizojë marrëveshjet të cilat i kanë komunat. Domethënë, jemi në proces të interpretimit ligjor.

Unë e kam nxjerrë një nen që ka të bëjë me marrëveshjen tonë me bankat, që nënkupton që bankat pajtohen që nuk duhet ta ngarkojmë pensionistin, apo të jetë me asnjë tarifë shtesë në llogarinë e tyre bankare për skemat që i marrin. Sidoqoftë, është një temë të cilin jemi duke e trajtuar dhe shpejt do të dalim në opinion me një interpretim ligjor. Por, mendimi im personal është që kjo duhet të ndërpritet dhe nuk duhet të vazhdojmë kështu.

E kemi edhe një vendim tjetër të Qeverisë, tash besoj që ligji do të vijë edhe në Kuvend, që ka të bëjë me faljen e borxheve publike, ku preken edhe këto. Kështu që besoj në dy sfera, në dy drejtime, do ta prekim këtë çështje dhe ta ndalojmë këtë dukuri e cila po ndodh për momentin. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Haxhiu, ke pyetje shtesë?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Jo pyetje shtesë, por uroj që të mos jetë periudhë e gjatë, sepse me të vërtetë këta qytetarë kanë dy vjet që u ndalet pensioni i moshës. Pra, uroj ministër që të merrni hapa konkretë në një afat pak më të shkurtër kohor. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Hashim Thaçi.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Normalisht se nuk është zëvendëskryeministri Thaçi këtu, në fakt ministri i Punëve të jashtme këtu. Uroj që ai të punojë diçka, edhe pse rezultate nuk ka, por po e presim kurdo që të vijë t'ia parashtrojmë pyetjen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Çështja ka të bëjë me mbrojtjen e punëtorëve në punë, që është një nga objektivat, edhe tuaja, edhe të Inspektoratit të Punës. Rastet e lëndimit në punë me pasoja tragjike kanë qenë të shpeshta, përdorimi i mjeteve mbrojtëse është detyrim, bashkë me masa tjera për sigurinë në punë.

Para më shumë se një muaji u kam parashtruar pyetje parlamentare për shkeljen e të drejtave të punëtorëve, jo vetëm në sektorin privat, por me theks të veçantë për të drejtat e punëtorëve në sektorin publik dhe, në veçanti, te ndërmarrjet e privatizuara dhe ato shoqërore që janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Muaj më parë, Inspektorati i Punës e ka inspektuar ndërmarrjen “Trepça”, që është nën menaxhimin e AKP-së. Në bazë të raportit të inspektimit të Inspektoratit të Punës në “Trepçë” është gjetur numër i madh i shkeljeve të Ligjit të punës.

Pyetja është, i nderuar ministër: a mund të na njoftoni në detaje për shkeljet ligjore që janë hasur në “Trepçë” gjatë inspektimit që ka bërë Inspektorati i Punës? A mund të na tregoni se të çfarë natyre kanë qenë këto të shkelje të gjetura në “Trepçë”? Cilat janë vendime të Inspektoratit të Punës pas këtij inspektimi? A janë ndërmarrë masa ndëshkimore për t’i evituar shkeljet në punë dhe shkeljet ligjore? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: I nderuar kryesues,

Ministra e deputetë,

Zoti Haxhiu, faleminderit për pyetjen!

Siç e dini, ngritja e kapaciteteve, rritja e numrit të vetë inspektorëve është një prej synimeve kryesore edhe të miave, por edhe të Ministrisë së Qeverisë, dhe patjetër ka hapësirë të punohet këtu dhe kërkojmë ndihmë, realisht edhe kemi kërkuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë që t’i marrim praktikat më të mira.

Sa i përket rastit të “Trepçës”, unë kam kërkuar nga Inspektorati raport zyrtar, i cili është realisht i gjatë dhe prek shumë elemente që ndoshta edhe mund të klasifikohen si të..., por sidoqoftë në raportin zyrtar në fund të vitit 2014, kur është bërë inspektimi, është dhënë një numër i vërejtjeve e kjo ka të bëjë me vërejtjet brenda kompleksit “Trepça”, që kanë të bëjnë me kontratat e punës, sikur përshkrimi i punës, i detyrave të punës, kohëzgjatja e pushimeve, kontratat me punonjësit, shfuqizimi i akteve që lidhen me punësimin, moszbatimin. Sidoqoftë, inspektorati ka dhënë vërejtje dhe ka kërkuar nga “Trepça” në këtë rast që t’i zbatojë këto vërejtje.

Ekziston edhe një raport tjetër, një vizitë tjetër që ka bërë Inspektorati, më 19 shkurt 2015, dhe ka kërkuar eliminimin e parregullsive të konstatuara në raportin e mëhershëm dhe ka kërkuar që afati i eliminimit të shtyhet deri më 15 prill 2015.

“Trepça” patjetër se me shkresa të ndryshme e ka informuar Inspektoratin me detyrat dhe me punët të cilat i ka ndërmarrë në këtë veprim.

Ekziston edhe një raport tjetër, që ka të bëjë me vizitën e Inspektoratit në kompleksin “Trepça”, ka të bëjë me kërkesat e punonjësve që janë larguar dhe njëra nga kërkesat është e bazuar dhe Inspektorati në këtë rast ka kërkuar nga ndërmarrja “Trepça” që ta revokojë aktvendimin e mëhershëm, me të cilin është larguar përkohësisht punonjësi në fjalë, pa dashur të përmend emra.

Inspektorati i ka vazhduar kërkesat dhe inspektimet dhe ndërmarrja “Trepça” më 12 maj ka ushtruar ankesë ndaj vendimit të Inspektoratit dhe tani ajo gjendet në shkallën e dytë.

Realisht, domethënë gjatë këtij viti Inspektorati i ka bërë disa vizita në “Trepçë” dhe ka gjetur parregullsi, ka bërë disa vërejtje. Por, vetë raporti është i gjatë, e në qoftë se bëhet edhe kërkesa me shkrim, unë jam i gatshëm ta përcjell këtë edhe në formë të shkruar. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Haxhiu, ke pyetje shtesë.

BEKIM HYSHIU: Faleminderit!

Shumë shkurt, ministër! Duke pasur parasysh që vdekjet në punë kanë qenë bukur të shpeshta dhe vitin e kaluar kemi pasur edhe vdekje të minatorëve për shkak të mosrespektimit të Ligjit të punës nga vetë menaxhmenti. Prandaj, pyetja ime shtesë është: Këto shkeljet ligjore, të cilat janë hasur herën e parë nga Inspektorati i Punës, me elemente të veprës penale, pse i ka adresuar, mirëpo me inspektimet tjera pastaj është munduar t’i mbulojë? Detyrë e Inspektoratit është që shkeljet ligjore t’i adresojë në institucionet përkatëse, e jo pastaj me riinspektimet t’i mbulojë shkeljet ligjore, të cilat i ka gjetur.

KRYESUESI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Ashtu siç thashë, domethënë ngritja e kapaciteteve brenda Inspektoratit është e nevojshme, gjithashtu edhe në shumë fusha tjera, dhe ajo çka kam kërkuar unë është që të rritet numri i vizitave bazuar në analizat e riskut, kështu që ne ose Inspektorati mund të ketë. Vendimet e Inspektoratit, ashtu siç jeni edhe ju të informuar, janë të pavarura, realisht unë asnjëherë nuk ndërhyj. Por, sidoqoftë, në qoftë se shihet raporti, mund të vërejmë se te ky kompleks, ose te kjo industri, raportet apo vizitat kanë qenë më të shpeshta, gjë që ka treguar një aktivizim më të madh të Inspektoratit, e kjo duhet të përshëndetet. Patjetër se duhet të punohet më shumë në fuqizimin dhe në ngritjen e kapaciteteve, por secila vërejtje të cilën ju e keni patjetër se do ta trajtojmë në kabinet dhe ta vazhdojmë tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përsëri deputeti Bekim haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Kujtim Shala.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër dhe ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Çështja ka të bëjë se në bazë të Ligjit të shëndetësisë, neni 33, mjekësia sportive është organizuar në nivelin dytësor dhe tretësor, me qëllim të përkujdesit për gjendjen shëndetësore të sportistëve aktivë dhe qytetarëve që merren në mënyrë aktive me sport. Edhe me Ligjin për sport përcaktohet se personat të cilët në klube sportive aktivisht zhvillojnë veprimtari sportive janë të detyruar t’u nënshtrohen kontrolleve mjekësore sistematike gjatë kohës së pjesëmarrjes në veprimtarinë sportive. Kontrollin shëndetësor të pjesëmarrësve në veprimtarinë e kryen mjeku

specialist i mjekësisë sportive në Qendrën e Mjekësisë Sportive, të licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, ku çdo sportist pastaj pajiset me kartelë mjekësore.

Gjithashtu, përdorimi i substancave dhe metodave të ndaluara stimuluese, si dhe nxitja për përdorimin e tyre dënohet sipas normave ndërkombëtare, të pranuar nga federatat e sporteve përkatëse me aktet normative të tyre dhe për këtë arsye kontrollet mjekësore duhet të jenë profesionale dhe të kryhen në qendrat e licencuara sipas ligjit.

Deri më tani, një qendër është e licencuar sipas ligjit dhe ajo është Qendra e Mjekësisë Sportive te Pallati i Rinisë. I nderuar, ministër, a jeni i informuar se Komiteti Olimpik i Kosovës nuk është duke i kryer kontrollet mjekësore për sportistët kulminantë sipas Ligjit për shëndetësi dhe Ligjit për sport? Si është e mundur që klubet dhe federata sportive t'i kryejnë kontrollet mjekësore sipas ligjit, ndërsa Komiteti Olimpik jo dhe planifikon që këta sportistë t'i dërgojë në lojërat olimpike pa kontrollime mjekësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër Shala, urdhëro!

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari deputet Haxhiu,

Mjekësia sportive e paraqet një standard domosdoshëm të sportit kulmor, testimëve dhe verifikimit të sportistëve për t'i plotësuar kushtet e pjesëmarrësve në aktivitetet sportive, për t'i vlerësuar rezultatet, si dhe për të konstatuar nëse të arriturat sportive kanë qenë në harmoni me rregullat e dispozitat e aplikueshme, të pranuar ndërkombëtarisht.

Në këtë drejtim, ne synojmë një qendër të mjekësisë së sportit me aparaturën e nevojshme për t'i zyrtarizuar dhe për t'i bërë të obligueshme kontrollimet mjekësore për të gjithë sportistët dhe klubet sportive që garojnë në kuadër të federatave. Kjo edhe për shkak se një numër jo i vogël i federatave tashmë janë pranuar ndërkombëtarisht dhe për pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare kërkojnë testet e antidopingut dhe testet e tjera të parapara për garat zyrtare.

Në Ligjin për sportin, kjo çështje është normuar siç thatë ju me nenin 33, ndërkaq pjesa teknike me nenet 60, 61, 62, 63 dhe 64. Sa i përket Komitetit Olimpik të Kosovës, ai është institucioni më i lartë sportiv në vend dhe funksionon në bazë të statutit, të rregulloreve dhe programeve të veta, që lidhen kryesisht me ciklet olimpike. Por, meqë edhe veprimtaria e Komitetit Olimpik të Kosovës i referohet si bazë legjislacionit të njëjtë, është i detyruar që t'i përmbushë këto norma.

Domethënë, Komiteti Olimpik i Kosovës duhet t'i kryejë të gjitha kontrollet në përputhje me nenet e lartcekura. Nga të dhënat që kemi marrë, e që lidhen me pyetjen tuaj konkretisht, nga Komiteti Olimpik i Kosovës kësaj radhe për ta përmbushur këtë standard, ky komitet ka bashkëpunuar me stafin mjekësor të Komitetit Olimpik të Republikës së Shqipërisë dhe kjo është konstatuar si një praktikë e pranueshme për Komitetin Olimpik Ndërkombëtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Haxhiu, ke pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar zëvendëskryeministër dhe ministër, sapo e pohuat me shkresën e Komitetit Olimpik që kanë bërë shkelje ligjore të legjislacionit në Kosovë dhe nuk e kanë përmbushur kriterin ligjor për kontrollim sistematik për sportistët dhe këtu e kam një listë që e ka prezantuar më 21 maj Komiteti Olimpik të pjesëmarrësve në lojërat olimpike në Baku dhe në të parashihet që me 55 delegatë apo udhëtues që do të jenë atje, do të jetë kryetari Besim Hasani me bashkëshorten dhe pritet që të jetë edhe sekretari, dhe gjithsej ky delegacion prej 55 vetave, i nderuar ministër besoni, apo jo 18 janë garues, 9 janë trajnerë dhe 28 janë zyrtarë të tjerë “Besimi Company”, pa asnjë doktor!

Asnjë mjek nuk do të jetë me sportistët tanë në lojërat olimpike në Baku. Pyetja është: A e ke pyetur kryetarin e Komitetit Olimpik se ku po mendojnë që po shkojnë këta? A janë duke shkuar për ta përfaqësuar Kosovën atje? Kush përkujdeset për shëndetin e këtyre sportistëve, apo janë duke shkuar për të bërë vizita qejfi?

KRYESUESI: Ministër, sa më shkurt, më mirë i bie!

MINISTRI KUJTIM SHALA: Po, pra, sipas të dhënave të Komitetit Olimpik të Kosovës kësaj here ata do të bashkëpunojnë me stafin mjekësor të Komitetit Olimpik të Shqipërisë. Kjo është përgjigjja. E sa i takon funksionimit të Komitetit Olimpik të Kosovës, ju e dini që po sipas të njëjtit ligj, do të thotë Ligjit për sportin, ai është një institucion, një organizëm i pavarur dhe Ministria e Kulturës bashkëpunon vetëm në bazë të memorandumeve të mirëkuptimit, të cilat i përcaktojnë politikat e bashkëpunimit, por s’ka të bëjë me standardet e brendshme të Komitetit Olimpik të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Haxhi Shala, pyetje për ministrin Memli Krasniqi.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Unë e kam ngrehur një shqetësim të fermerëve të Republikës së Kosovës lidhur me ndalimin e matrikulimit të kafshëve, ose shenjëzimin e tyre me numër identifikues në vesh.

Shumë fermerë diskriminohen për shkak të këtij udhëzimi administrativ, që është vendosur nga Ministria e Bujqësisë, respektivisht nga AVUK-u. Pyetja për ministrin: Pse nuk bëhet me kohë matrikulimi, shenjëzimi i kafshëve që fermerët të arrijnë t’i tërheqin subvencionet me kohë, zoti ministër?

KRYESUESI: Ministër Krasniqi, urdhëroni!

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: I nderuar zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

I nderuar zoti deputet,

Më lejoni të them që e keni shtruar një pyetje për kompetencat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës dhe ju e dini që kjo agjenci nuk është nën autorizimin apo kompetencën e Ministrisë së Bujqësisë, por të Zyrës së Kryeministrit dhe rrjedhimisht unë nuk jam në një pozicion që t’jua jap një përgjigje zyrtare.

Megjithatë, kam kërkuar informacione nga zyrtarët udhëheqës të agjencisë dhe ata më kanë njoftuar se një gjë e tillë nuk ka ndodhur, përveç për disa ditë në rajonin e Ferizajt, të Shtimes dhe po ashtu të Suharekës, kur për një periudhë të shkurtër kohore kanë skaduar kontratat e agjencisë me veterinerët e autorizuar, por asnjë fermer nuk është vonuar me rastin e kërkesës për matrikulimin e kafshëve, pra që është kompetencë që realizohet nga AVUK-u.

Sa u përket subvencioneve, më lejoni t'ju them që pikërisht për këtë sektor, sektorin e subvencionimit të lopëve qumështore, ne në këtë vit e kemi një buxhet rekord. Janë 3 milionë e 80 mijë euro të planifikuara për subvencionimin e tyre, hera e parë është që e kemi rritur edhe masën e subvencionimit nga 50 në 70 euro për krerë, ndërsa e kemi rritur po ashtu edhe buxhetin e planifikuar për subvencionimin e litrit të qumështit, sipas cilësisë, ku sot kemi të planifikuara rreth 1 milion e gjysmë.

Pra, absolutisht është sektor i mbështetur jashtëzakonisht shumë sikur gjithë vitet e kaluara dhe unë besoj që Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës do të jetë në krye të detyrave të veta për t'u ofruar shërbimet sipas legjislacionit në fuqi të gjithë fermerëve, të cilët janë të interesuar për një shërbim të tillë të matrikulimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ke pyetje shtesë, zoti Shala?

HAXHI SHALA: Pyetje nuk kam, por vetëm desha ta bëj një koment. Është e vërtetë që ka shtesë të subvencioneve nga Ministria juaj, por terreni tregon diçka tjetër - nuk janë të regjistruara kafshët me kohë. Tash që është 6-mujori i parë, në qoftë se deri në qershor nuk bëhet shenjëzimi i kafshëve, ata veç i humbin subvencionet që i marrin nga Ministria e Bujqësisë.

Kështu që kërkoj nga ju, zoti ministër, që ta kërkojë një raport nga AVUK-u, edhe pse është kompetencë e kryeministrit, por subvencionet ndahen nga Ministria e Bujqësisë, kurse shenjëzimi nuk është duke u kryer ashtu siç kërkohet me kohë dhe sipas udhëzuesit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti deputet!

Unë besoj që shumë shpejt ne këtu bashkërisht në Kuvendin e Kosovës do ta miratojmë Ligjin për ushqimin dhe do ta transferojmë më në fund Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës në Ministrinë e Bujqësisë, aty ku e ka vendin, dhe pastaj do ta kemi shumë më lehtë që t'i trajtojmë edhe çështjet, të cilat ju i ngrehni. Ndërsa, për sa i përket çështjes së matrikulimit, unë edhe një herë nga informacionet që kam pikërisht nga udhëheqësit e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës jam njoftuar se këtë vit nuk ka pasur vonesa për matrikulimin e atyre gjedheve, të cilat i plotësojnë kushtet sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore që e rregullojnë konkretisht këtë fushë, e tani ato gjedhe që mund ta kenë prejardhjen e dyshimtë, që mund të jenë në rastin më të keq edhe subjekt i kontrabandimit në territorin e Republikës së Kosovës, kjo është pak problem, sepse nuk mund t'i matrikulojmë pa e pasur dëshminë e prejardhjes.

Unë besoj që në këtë drejtim duhet të na ndihmojnë edhe instancat tjera për zbatimin e ligjit, sepse ju e dini që kontrabandimi me gjedhe ka qenë dhe mbetet një sfidë e madhe dhe normalisht

që Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës ka përgjegjësi që ta adresojë këtë çështje edhe në kuadër të matikulimit, në mënyrë që të mos bëhet legalizimi i paqëllimshëm ose i qëllimshëm i gjedheve, të cilat të cilat mund të hyjnë nëpërmjet formave të kontrabandës apo gjedheve, të cilave nuk u dihet prejardhja, ashtu siç e kërkon legjislacioni në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Kush nuk vjen në klasë ditën që ka provim, ose nuk është i përgatitur, ose i pëlqen më shumë të shëtisë rrugëve. Unë nuk e di çfarë shpjegimi keni ju zoti kryesues, por nëse injoranca ka një emër, nëse fodullëku e ka një emër, nëse e ka një emër për papërgjegjësinë, atëherë ky emër është Qeveria e Republikës së Kosovës për arsyet që po i shihni edhe ju këtu.

Shumica e ministrave, të cilët mbajnë përgjegjësi nuk po u përgjigjen pyetjeve parlamentare dhe e dyta, po shfrytëzoj këtë rast për të thënë, më vjen keq që zoti Veseli nuk është këtu, por herën e fundit kritikoi për disa shprehje si “kriminel”, “mafioz”, e “bandit”, e unë këtu kam gazetën “Shpiegel”, ku nënkryetarja e Kuvendit i quan disa mafiozë të FIFA-së, i quan “kriminelë”, vjen edhe shprehja “mafi”, pastaj vjen edhe shprehja “banditë”. Kështu, që ata që janë kriminelë, ata që janë banditë, ata që janë mafiozë, duhet quajtur me emrat e tyre të vërtetë. Kaq! Faleminderit!

KRYESUESI: Po të komentoja, ju do të thoni je aty ta drejtosh seancën, kështu që s’do të komentoj asgjë. Kur ta marr fjalën, do të flas. Shkojmë tutje!

Deputeti Rexhep Selimi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Urdhëro, Rexhep Selimi!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryesues!

Është hera e tretë që të njëjtën pyetje ia adresoj kryeministrit të Kosovës dhe po ashtu, më duket që jo hera tretë, por më shumë se kaq, është mungesa e kryeministrit të Kosovës në seanca kur ka pyetje parlamentare.

Unë po e rezervoj të drejtën që në përputhje me Rregulloren, këtë pyetje ta bart për seancën e ardhshme, duke shpresuar që ai do të jetë i gatshëm të përgjigjet në pyetjen parlamentare, e cila ka të bëjë me një çështje goxha të ndjeshme dhe shumë të përfolur lidhur me ngjarjet në fushën e sigurisë, e që kanë të bëjnë me ngjarjet që ndodhën ditë më parë në Kumanovë. Pres përgjigjen e tij dhe s’po kuptoj pse nuk përgjigjet në këto tema, kur edhe interes i vetë kryeministrit do të ishte të përgjigjet. Kështu që po e rezervoj të drejtën për ta bërë pyetjen në seancën e ardhshme eventualisht, nëse kryeministri është i gatshëm t’i përgjigjet Kuvendit.

KRYESUESI: Koha për pyetje kaloi, i kemi shqyrtuar të gjitha. Në sallë i kemi 64 deputetë.

3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme

Të nderuar deputetë,

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 15, 18, 21 dhe 28 maj 2015. Nëse nuk ka, konsideroj që këto procesverbale të seancave të kaluara janë miratuar.

Kalojmë tutje. Të nderuar deputetë, lidhur me interpelancën me ministrin e Punëve të Jashtme, zoti Hashim Thaçi, në mbledhjen e Kryesisë me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 1 qershor, është arritur marrëveshja me propozuesin e interpelancës se në rast se ministri i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, e njofton Kuvendin për pamundësinë e pranisë së tij në seancë plenare, interpelanca të shtyhet në seancën e radhës.

Qeveria dje ka treguar me shkrim në Kuvend se zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm Thaçi nuk do të jetë sot këtu. Pra, kalojmë tutje. Për rend të ditës?

Urdhëro, Donika Kadaj-Bujupi e ke fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit! Po dua ta tërheq vëmendjen, u diskutua edhe nga kolegët tjerë deputetë, që në bazë të nenit 65.9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Qeveria dhe ministrat duhet të jenë të gatshëm që t'i raportojnë Kuvendit sa herë të thirren.

Nuk qëndron fakti, këtë po e them për transkript, që ministri nuk është këtu, sepse ai sot në mëngjes për çështje lotimi, qysh bën kryesisht, u duk nëpër korridore dhe ishte këtu, por nuk është i gatshëm të vijë dhe të raportojë para deputetëve, ndërkohë që Kosova po rrezikon t'i humbë edhe 12 mijë hektarë tokë, që nuk janë të ministrit, por janë të qytetarëve të brezit kufitar dhe është shumë e udhës të vijë sa më parë të raportojë, e të na japë shpjegime se çfarë po ndodh dhe cilat kanë qenë koncesionet e reja, të cilat ai i ka ndërmarrë, e jo të ikë, se kjo është një ikje prej përgjegjësisë dhe është shkelje e Kushtetutës.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë thashë vetëm evidenca, unë edhe vetë kam qenë në Kryesi, ku ju jeni pajtuar, e pse jeni pajtuar është problem juaji. Faleminderit!

Për rend të ditës, Adem Grabovci, shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, e ka kërkuar.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ne në konsultim me shefat e grupeve parlamentare dhe deputetët e koalicionit kërkojmë që pika 5 e rendit të ditës, duke pas parasysh rëndësinë që e ka ky institucion, ku duhet të zgjidhen dy anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, për shkak të mungesës së një numri të madh të deputetëve, të cilët janë në udhëtim zyrtar, të shtyhet për një seancë tjetër të radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Po e hedh në votim kërkesën e Grabovcit, që kjo pikë e rendit të ditës për shkak të rëndësisë të asaj që do të votohet dhe mungesës së madhe të deputetëve të shtyhet në një seancë tjetër.

Kush është për? Faleminderit! Shumica. Kush është kundër? A ka kundër? Numëroni kush është kundër. Me shumicën e deputetëve për, me 17 vota kundër, shtyhet votimi i gjyqtarëve për Gjykatën Kushtetuese për një mbledhje tjetër.

6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Komisioni për Legjislacion ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe Kuvendit ia ka paraqitur raport me rekomandime.

Fjalën e ka kryetarja e Komisionit për Legjislacion, deputetja Albulena Haxhiu, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

Albulena! A po flet dikush në vend të Albulenës, apo askush? Nëse jo, atëherë kalojmë te kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të LDK-së, Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Nënkryetar!

Në fakt, pasi s'është as kryetarja e komisionit, as ministri i Drejtësisë, meqë ky ligj bie në fushëveprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë, që ka të bëjë me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, për zbatueshmërinë e tij, por edhe me gjendjen që ekziston në burgjet e Republikës së Kosovës, unë po e shoh që ne mund të debatojmë, mund të flasim për këto rekomandime, por nëse s'kemi përgjigje, atëherë mbeten vetëm rekomandime të komisionit, por edhe të Kuvendit, nëse e marrin votën për. Kështu, le të vendosë edhe Kuvendi, le të vendosin edhe grupet parlamentare. Ne jemi të gatshëm që të raportojmë, ta japim mendimin tonë si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, por edhe si anëtarë të Komisionit për Legjislacion.

Në emër të grupit, flet Agim Ademaj.

KRYESUESI: Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Fillimisht ju kërkoj ndjesë që nuk isha më përpara këtu, meqë kjo pikë ka qenë si pikë e gjashtë e rendit të ditës dhe nuk e kisha ditur që do të procedohet kaq shpejt.

Meqë nuk është ministri i Drejtësisë këtu, unë nuk po e kuptoj se pse duhet ta diskutojmë këtë çështje, edhe pse është tepër e rëndësishme. Ministri i Drejtësisë ka qenë i informuar që do të bëhet debati në lidhje me monitorimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe meqë Ministria e Drejtësisë është kompetente për t'u siguruar që ky ligj të zbatohet në përpikëri, atëherë është dashur që të paktën të jetë i pranishëm. Kësisoj, si kryetare e Komisionit për Legjislacion po besoj që e kam miratimin edhe të anëtarëve të komisionit, por kërkoj që kjo çështje të shtyhet deri në seancën e ardhshme, sepse nuk ka kuptim që të diskutohet ky raport pa ministrin e Drejtësisë.

KRYESUESI: Ti s'do as të paraqitësh raport! Domethënë, kërkesa e kryetares së grupit është që, meqë nuk është ministri i Drejtësisë këtu, raporti të mos diskutohet. Është e drejta juaj ta votoni, apo të mos e votoni.

Është mocion që nga kryetarja dhe një anëtar, a je edhe ti anëtar, që pika të mos shqyrtohet meqë nuk është ministri i Drejtësisë. Partitë tjera, duan të prononcohen, apo po e kalojmë në votim? E nxjerr në votim këtë mocion, që të shtyhet pika e rendit të ditës.

Kush është për? Kush është kundër? S'ka kundër. Njëzëri kjo pikë e rendit të ditës shtyhet derisa të jetë i pranishëm ministri i Drejtësisë.

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor për cilësinë e grurit të importuar

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka bërë mbikëqyrjen e cilësisë së grurit të importuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Raportues i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor është Adem Salihaj, që do ta bëjë arsyetimin e raportit me rekomandime. Deputeti Salihaj e ka fjalën.

ADEM SALIHAI: Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti kryesues,

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në bazë të nenit 69 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës është njëri nga komisionet funksionale, i cili në kuadër të fushëveprimit dhe përgjegjësisë i shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me bujqësinë, pylltarinë, zhvillimin rural dhe mjedisin e planifikimin hapësinor.

Komisioni, duke ndjekur shqetësimet serioze të qytetarëve të Kosovës, lidhur me cilësinë e grurit të importuar, veçanërisht atij nga Serbia, në bazë të kompetencave të tij, në mbledhjen e mbajtur më 10 shkurt 2015, e inicioi mbikëqyrjen e kësaj çështjeje.

Pas disa debateve dhe raportimeve të institucioneve kompetente, komisioni vërejti se kishte arsye për këto shqetësime, prandaj për t'i hulumtuar çështjet që lidheshin me cilësinë e grurit të importuar dhe përpunimit të tij të mëtijshëm në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, e formoi një grup punues. Grupi punues i kryesuar nga deputeti Salih Salihu dhe anëtarët Adem Salihaj, Lahi Brahimaj, Shaip Muja dhe Haxhi Shala, për t'i hulumtuar këto shqetësime realizoi një numër të madh kontaktesh dhe vizitash në terren me të gjithë faktorët kompetentë për këtë çështje dhe duke grumbulluar materiale të shumta.

Dëshiroj ta informoj Kuvendin shkurtimisht se grupi punues dhe Komisioni kanë pasur kontakte dhe kanë trajtuar këto institucione: Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës së Kosovës, Doganën e Kosovës, Institutin Bujqësor të Kosovës në Pejë, Kompaninë M-Silloi në Xërxë, si dhe disa subjekte afariste, që kanë të bëjnë me çështjen e importit, respektivisht distribuimin e grurit të përpunuar nga importi. Po ashtu, Komisioni ka bërë përpjekje që të kontaktojë me Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim, në fakt vetëm për Bujqësi, Pylltari, si dhe me Qeverinë, pra kryeministrin, por nuk ka pasur sukses, për arsye se këto institucione nuk i kanë raportuar Komisionit.

Pas shumë vizitash dhe kontakteve, mbledhjes së materialit, shqyrtimit në Komision, Komisioni ka nxjerrë disa konstatime në bazë të së cilave më vonë ka nxjerrë edhe rekomandime për Kuvendin. Meqë, raportin e keni të plotë, unë do t'i lexoj konstatimet e Komisionit si dhe rekomandimet që i paraqet para Kuvendit.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, pas një pune intensive tremuajshe, pasi dëgjoi gati të gjithë faktorët që ishin të involvuar në çështjen e importit të grurit, nxori këto konstatime.

1. Gjatë vitit 2014 janë importuar nga Serbia së paku 10 mijë tonë të grurit për ushqim për kafshë. Nga hulumtimi që ka bërë Komisioni kanë rezultuar mjaftë fakte, se kjo sasi e grurit është bluar dhe shitur edhe si miell, pra edhe si ushqim për njerëz. Të gjitha të dhënat dhe informatat e ofruara nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës, kanë qenë kontradiktore dhe të pasakta. Numri i deklaruar i mostrave të dërguara nga kjo Agjenci për analiza në Institutin Bujqësor të Kosovës, në Pejë, nuk gjendet në librat e evidencës së këtij Instituti. Sipas pohimeve të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës gjatë vitit 2014, në Institutin Bujqësor të Kosovës, në Pejë, janë dërguar 70 mostra për analiza, kurse sipas librave të evidencës, janë dërguar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës dhe Dogana e Kosovës, bashkë, vetëm 30 mostra për analiza.

2. Sipas deklarimit të AUV-it, deri në mes të muajit shkurt 2015, në IPK janë dërguar për analiza 79 mostra, ndërsa sipas evidencës së IPK-së nga AUV-i janë dërguar vetëm 14 mostra për analiza. Gjithashtu, në raportin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës thuhet se sipas rezultateve të tyre, janë importuar vetëm 1 166 tonë grurë, nga kompania M-Silosi për ushqim të kafshëve, ndërsa vetë kompania M-Silosi thotë se ka importuar së paku 10 mijë tonë grurë për ushqim për kafshë.

3. Sipas vlerësimit të Komisionit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës nuk është aspak në nivelin e detyrës dhe nuk e bën një kontroll të mirëfilltë në aspektin e sigurisë së ushqimit dhe, si pasojë, qytetarët e Kosovës nuk ushqehen me ushqim cilësor dhe të kontrolluar si duhet.

4. Sipas vlerësimit të Komisionit nuk ka ekzistuar dhe as tash nuk ekziston asnjë mbikëqyrje serioze e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës nga Qeveria e Kosovës.

5. Në çështjen e kontrollit të ushqimit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, punojnë persona të cilët nuk kanë kualifikime përkatëse dhe as njohuri të duhura për sëmundjet e bimëve.

6. Gjatë muajit qershor 2014, nga tërë sasia e importuar nga një importues gjatë këtij muaji prej 5210 tonësh, ose prej 2800 maunash grurë, inspektori fito-sanitar i Agjencisë ka dërguar vetëm një mostër të vetme për analiza në Institutin Bujqësor të Pejës.

Në gusht të vitit 2014, inspektori fitosanitar i Agjencisë ka dërguar vetëm një mostër për analiza në gjithë sasinë e grurit të importuar prej 8056 tonësh, ose 322 maunesh me grurë. Situatë e ngjashme ka qenë edhe në muajin nëntor 2014, kur prej 1131 tonë grurë është dërguar vetëm një mostër për analiza.

7. Instituti Bujqësor i Kosovës është institucion që i bën analizat e ushqimit me origjinë bimore, por përkundër faktit që institucionet e Kosovës mbështeten ekskluzivisht në analizat e ushqimit me origjinë bimore të bëra në këtë Institut, ky laborator nuk është i akredituar.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në përgjegjësinë e së cilës është ky Institut, nuk i ka kushtuar atij vëmendjen e duhur, që të kërkojë nga menaxhmenti i IPK-së të aplikojë për akreditim.

8. Dogana e Kosovës nuk ka qenë konsekuente në kontrollin e grurit që vjen nga importi. Deklarimi i tyre se dërgohen për analiza mostrat nga secila maune me grurë nga importi, nuk ka rezultuar i saktë. Në anën tjetër, përfaqësuesit e Doganës së Kosovës, në takimin me përfaqësuesit e komisioneve, kanë qenë kontradiktorë lidhur me sasinë e grurit të importuar për ushqim për kafshë.

9. Përfaqësuesit e Doganës fillimisht kanë deklaruar se janë importuar rreth 500 tonë, në ndërkohë që gjatë diskutimit dhe verifikimit të statistikave, pranohet se janë importuar mbi 10 mijë tonë grurë për ushqim të kafshëve, gjë që përbën një ndryshim esencial.

10. Sipas Doganës së Kosovës, i gjithë gruri i importuar shkon për eksport. Komisioni ka vërtetuar se ky konstatim nuk qëndron, për arsye se sasi të mëdha të grurit të importuar dhe të përpunuar nga kompani të ndryshme, plasohen edhe në tregun e Kosovës. Kjo e dhënë është vërtetuar edhe përmes Administratës Tatimore të Kosovës dhe vetë operatorëve ekonomikë.

Dogana e Kosovës, të gjithë importuesit e grurit i trajton me procedura të pezulluara sipas Kodit doganor IM-5 dhe IM-7. Kjo do të thotë se këta importues nuk paguajnë asnjë lloj takse në Doganën e Kosovës. Këto forma të importit krijojnë mundësi për manipulime, duke pasur këtë favor këta importues e plasojnë tregun e Kosovës, grurin apo prodhimet e tij, me çmim më të lirë, sesa prodhuesit kosovarë të grurit.

Këto veprime dhe këto forma të importit të grurit kanë shkaktuar evazion fiskal, duke dëmtuar seriozisht prodhimin vendor të grurit në Kosovës.

11. Duhet theksuar faktin se të tri këto institucione, pra Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, Dogana e Kosovës dhe Instituti Bujqësor i Pejës i kanë ndryshuar deklaratimet dhe të dhënat e ofruara gjatë fazave të ndryshme të këtij shqyrtimi, pra nuk kanë qenë konsekuente në deklaratimet e tyre.

Bazuar në këto konstatime, komisioni ia rekomandon Kuvendit këto rekomandime:

1. Qeveria të ndërmarrë veprimet e duhura në ngritjen e përgjegjësisë së stafit udhëheqës të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, në zbatim të ligjit, në mënyrë që popullata e Kosovës të jetë e mbrojtur nga produktet ushqimore të dyshimta;

2. Të krijohet një sistem i avancuar i data-bazës për regjistrimin e të gjitha kontrollimeve fito-sanitare dhe veterinare të produkteve të importuara dhe atyre vendore.

3. Të ndryshohen politikat fiskale për grurin e importuar me qëllim të mbrojtjes dhe stimulimit të prodhimit vendor të grurit.

4. Qeveria të ketë një mbikëqyrje më serioze ndaj Doganës së Kosovës, në aspektin e zbatimit të Ligjit dhe Kodit doganor lidhur me taksat doganore për importuesit e grurit.

5. Të ndërmerren masa kontrolli e përgjegjësie ndaj përgjegjësve të Institutit Bujqësor të Kosovës, për ngritjen e nivelit të përgjegjësisë dhe atij profesional.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me menaxhmentin e Institutit Bujqësor të Kosovës, të ndërmarrë veprimet e duhura për akreditimin e laboratorit të këtij Instituti.

6. Të Kërkohet nga Administrata Tatimore e Kosovës një kontroll më i madh në çështjet e evazionit fiskal të importuesve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Në emër të grupeve, Shpejtim Bulliqi e ka fjalën në emër të LDK-së.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të respektohet deputetë,

Realisht, është për të ardhur keq, që ato të cilat disa deputetë në këtë sallë të Kuvendit, para ca muajsh i kanë ngritur si çështje, si probleme, realisht nga ana e këtij kontrolli që është realizuar prej Komisionit për Bujqësi kanë dalë realisht të vërteta.

Ç'është e vërteta, në këtë Komision unë po them, shfrytëzoj nga rasti që t'i përsëndes dhe t'i falënderoj këta anëtarë të këtij Komisioni, që kanë bërë këtë vëzhgim të kësaj situate dhe në bazë të krejt kësaj që po shihet, po del se vërtet, të gjitha ato brenga që janë ngritur më herët, në realitet po dalin se kanë qenë të vërteta.

Nga krejt këto rekomandime dhe kontrole që dalin nga ana e këtij Komisioni, faktikisht na del një situatë tepër alarmante, duke u nisur nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, pastaj doganave të Kosovës dhe Institutit Bujqësor të Kosovës.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës realisht, që ne kemi llogaritur se kemi një institucion, i cili po mbron qytetarin tonë dhe në njëfarë forme po e mbron nga ushqimet, të cilat mund të mos jenë të përdorshme, faktikisht po del se ky është një institucion, që nuk është fare i përgatitur me njerëz profesionistë, të cilët realisht duhet ta kontrollojnë edhe ta bëjnë këtë punë të tyre.

E dyta, Instituti Bujqësor i Kosovës që realisht është një Institut nga i cili dalin të gjitha këto vlera dhe këto parametra, po del që realisht edhe ky fare nuk është i akredituar dhe realisht, po shihet se në cilën gjendje ndodhet ushqimi, që konsumon popullata ose qytetarët e Kosovës.

Dhe e treta, që nuk është aspak për t'u hedhur anash, është çështja e punës që e bën Dogana e Kosovës.

Unë vetëm po referohem në këtë faktin e muajit qershor të vitit 2014, në të cilin thuhet se janë futur diku brenda territorit të Kosovës rreth 208 maune me grurë, i cili grurë realisht ka qenë grurë i klasës së parë dhe i cili është përdorë për prodhimin e miellit, që në realitet ka ardhur në emër të grurit për kafshë, ose të ushqimit për kafshë.

Në qoftë se, e bëjmë vetëm një kalkulim të vogël të këtij muaji, realisht 208 maune, që është dashur t'i paguajnë nga 800 euro çdonjëra maune taksë Kosovës, ose buxhetit të Kosovës, na del se vetëm në muajin qershor, domethënë Kosovës i janë hequr nga buxheti i saj diku nja 166 400 euro. Dhe, mund ta llogarisni se cili është dëmi total, që i është shkaktuar buxhetit të Kosovës me këto manipulime, të cilat realisht po dalin se kanë qenë të lidhura ndërmjet të AVUK-ut, Doganës së Kosovës dhe Institutit Bujqësor të Kosovës.

Sigurisht, se shuma në total e këtij dëmi që i është shkaktuar buxhetit të Kosovës mund të kalojë ose mund t'i ofrohet rreth njëmilionëshit.

Dhe, çështja tjetër ku desha të ndalem, te rekomandimet e Komisionit, unë mendoj që këto rekomandime është dashur të jenë më të ashpra, në drejtim të AVUK-ut, në drejtim të Institutit Bujqësor të Kosovës dhe njëkohësisht në drejtim të Doganave të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Kush flet për “Vetëvendosjen”, se jeni disa? Për “Vetëvendosjen” Besa Baftija është e para. Prandaj, po ju pyes, se këtu s'po shkruan. Salih Salihu e ka fjalën.

SALIH SALIHU: Të nderuar kolegë deputetë,

Kryesues,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pasi që kam qenë udhëheqës i këtij grupi punues, dua t'i diskutoj disa nga problemet kyçe që i kemi hasur si Komision gjatë hulumtimit të këtij rasti e që konsideroj se është me interes, që ju dhe qytetarët e Kosovës të informoheni.

1. Nga raporti i Agjencisë së Ushqimit thuhet se janë importuar vetëm 1166 tonë grurë për ushqimin e kafshëve, ndërkaq kompania M-Silos thotë se ka importuar 10 mijë tonë grurë për ushqimin e kafshëve. Tash këtu ka një dallim shumë të madh në sasi dhe, kjo normalisht duhet të sqarohet.

2. Doganat me deklarin e tyre fillimisht, thoshin se janë importuar rreth 500 tonë grurë për ushqim të kafshëve dhe në bisedë e sipër, pasi ne si Komision u tregojmë atyre që kompania në fjalë ka pranuar se ka importuar 10 mijë tonë grurë për ushqimin e kafshëve, në fund pranojnë edhe vetë, domethënë përfaqësuesit e doganave.

3. Përfaqësuesit e Doganave, në prani të mediave thonë, se i gjithë importi i grurit nga kompania M-Silos, shkon për eksport dhe si i tillë, as për grurin për ushqim për njerëz që importon, nuk paguan TVSH, sepse pas bluarjes miellin e eksportojnë jashtë vendit, ndërsa kompania M-Silos thotë se kjo nuk është e vërtetë, sepse ne shesim miell edhe në tregun e brendshëm të Kosovës.

4. Ajo që është shqetësuese, se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës si inspektorë fito-sanitar në terminalin në Prishtinë, ka përcaktuar një person nga Mitrovica e Veriut dhe shtrohet pyetja: pse

është bërë kjo, kur e dimë se as ATK-ja, as Prokuroria, as Policia nuk kanë qasje në Mitrovicën e Veriut dhe nuk mund ta ndjekin dikë, në rast se konstatohet se ka shkelje të ligjit gjatë kontrolleve fito-sanitare.

Ndryshimi i Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 19/2014 për respektimin e lartësisë së pagesës së shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ku përcakton se lartësia e tarifës së kontrollit fito-sanitar për një maune të importuar me grurë, nga 75 euro sa ishte më parë, është bërë 25 euro, ndërsa për një maune të importuar me miell, nga 75 euro sa ishte më parë, është bërë 175 euro.

Kjo masë ndikon në stopimin e importit të miellit dhe nxitjes së importit të grurit, për t'u bluar më pastaj në mullirin e caktuar.

Nga raporti që kemi marrë nga kompania M-Silos thuhet se kemi arritur të ulim çmimin e miellit deri në 25 centë për kilogram, mirëpo kolegë të nderuar, nëse kështu vazhdon, atëherë askush nuk do të mbjellë grurë në Kosovë, sepse kur çmimi i miellit bie në 25 centë gruri vendor nuk mund të shitet më shumë se 18 centë. Ndërsa, nuk ka fermer që mund të mbulohet me këtë çmim të grurit, sepse kostoja e prodhimit është po aq e lartë sa një kilogram grurë.

Prandaj, ju kolegë që merreni me ekonomi, më tregoni- a është më mirë t'u ofrojmë konsumatorëve miell të lirë deri në 25 centë për kilogram nga gruri i importuar nga Serbia dhe të varemi tërësisht nga importi kur dihet se Kosova ka nevojë për rreth 400 000 tonë grurë, që bëjnë rreth 800 milionë euro, apo t'i stimulojmë fermerët kosovarë, që këtë sasi të grurit ta prodhojmë në Kosovë dhe këto mjete të mbeten në Kosovë.

Një shembull shumë të keq e kemi, rastin e prodhimit të elbit në Kosovë. Dikur fermerët kosovarë kanë mbjellë rreth 10 mijë hektarë elb në Kosovë, ku pjesa më e madhe ka shkuar për Fabrikën e Birrës në Pejë, tash nuk kemi as 200 hektarë elb në Kosovë, sepse malta si lëndë të parë për prodhimin e birrës, që fitohet nga elbi, importohet nga Kroacia dhe Serbia.

Në situatë shumë të ngjashme të vështirë e kemi edhe sektorin e qumështit. Importi i pakontrolluar i qumështit dhe produkteve të tij me përmbajtje të yndyrës me origjinë bimore, po i shkatërron përpunuesit vendor dhe me këtë edhe prodhuesit e qumështit.

Përfaqësuesit e përpunuesve të qumështit dhe prodhuesve të qumështit të Kosovës, në takimin me Komisionin për Bujqësi thonë se nuk mund t'u bëjnë ballë këtyre produkteve të importuara, pa asnjë bazë ligjore dhe të dyshimta nga aspekti i përmbajtjes dhe cilësisë.

Në një situatë shumë të keqe kohët e fundit është edhe sektori i shpendarisë, konkretisht sektori i prodhimit të vezëve. Çmimi i vezëve ka pësuar një rënie drastike nga 3 euro për një tabelë deri në 1,5 euro, gjë që për një kohë të shkurtë tremujore do ta kolapsojë edhe këtë sektor.

Prandaj, të nderuar kolegë, ne konsiderojmë se është e kotë rritja e granteve dhe subvencioneve, në njërin anë dhe në anën tjetër, në mungesë të gatishmërisë së Qeverisë për t'i mbrojtur prodhimet vendore dhe me ndërhyrjen dhe ndërlihdjen e politikës me biznes, ta shkatërrosh po të njëjtin sektor.

Ndërkaq sa i përket aspektit të sigurisë ushqimore, kontrollit të përmbajtjes dhe cilësisë së produkteve të importuara, mund të themi se institucionet tona janë totalisht jashtë funksionit të tyre. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës nuk kontrollon produktet e importuara. Ne nuk e dimë se çfarë materie toksike, çfarë materie mbetje të pesticideve, çfarë metalesh të rënda përmbajnë produktet e importuara. Të gjitha këto elemente mund të shkaktojnë sëmundje kancerogjene, raste e të cilëve viteve të fundit janë bërë gjithnjë e më të shpeshta në Kosovë.

Instituti Bujqësor i Kosovës në Pejë ende është i pa akredituar. Është për keqardhje që ky institut që tetë vjet është nën ombrellën e Ministrisë së Bujqësisë, që të mos jetë i akredituar, ndërsa dy institucionet tona shtetërore, Agjencia e Ushqimit dhe Dogana bazohen në rezultatet e këtij ... nga Instituti Bujqësor i Pejës.

Doganat e Kosovës duket se është në kaos total dhe nën ndikimin e politikës dhe bizneseve të tyre. Vetë drejtori i Doganave të Kosovës thotë se janë rreth 300 agjentë doganorë që kanë lidhje familjare me doganierë, lidhjet e tyre me biznese dhe doganierë po e dëmtojnë rëndë prodhimin vendor dhe po rrezikojnë shëndetin publik.

Rastet e ndërrimit të kodit të mallit për ta mundësuar hyrjen e mallrave të ndaluara në tregun e Kosovës janë përditshmëri. Për shembull, ka shumë pesticide që janë të ndaluara me ligj, hyjnë në Kosovë dhe shiten lirshëm në tregun e Kosovës, duke dëmtuar kështu seriozisht cilësinë e bimëve dhe shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e PDK-së flet Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedavajući!

Parlamentarna Grupa PDK je u potpunosti razmotrila izveštaj komisije za poljoprivredu, šumarstvo, životnu sredinu, sa preporukama o kvalitetu uvezene pšenice u našoj državi i uz određene sugestije i primedbe svih poslanika unutar grupe iznela svoja zapažanja i dala mišljenje o procesu nadgledanja kvaliteta uvezene pšenice, gde je Vlada u obavezi da preduzme odgovarajuće mere za povećanje odgovornosti od strane Agencije za hranu na sprovođenju zakona, kako bi kosovsko stanovništvo bilo zaštićeno od sumnjivih prehrambenih proizvoda uz obavezno kontrolisanje fito-sanitarnih i veterinarskih uvezanih ali i domaćih prehrambenih proizvoda, uz obavezno menjanje fiskalne politike oko zaštite i podsticanje proizvodnje domaće pšenice.

Takođe je Parlamentarna Grupa PDK zahteva od Vlade veću ozbiljnost nadgledanja Kosovske Carine te preduzimanja kontrolnih mera i mere odgovornosti prema odgovornim licima u poljoprivrednom Institutu Kosova u cilju povećanja profesionalne i radne odgovornosti. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Për grupin “Nisma”, Enver Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi Nisma ka trajtuar raportin e Komisionit dhe me shqetësim të madh ka ardhur në përfundim se tri institucionet kompetente që janë: Instituti Bujqësor i Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe

Veterinës dhe Dogana e Kosovës, janë të dështuara në kryerjen e detyrave të tyre dhe po i dëmtojnë në masë të madhe qytetarët dhe vendin në dy aspekte.

Në njërën anë dëmtojnë prodhuesit vendorë dhe në anën tjetër dëmtojnë sigurinë dhe shëndetin e qytetarëve të vendit me gjithë ato veprime, të cilat i bëjnë nëpër këto institucione. Po ashtu, ne kërkojmë që këto rekomandime të forcohen dhe të përcillen në mënyrë strikte nga Qeveria dhe të merren masa ndaj këtyre institucioneve, të cilat po pasojnë në negativitet të madh për jetën dhe sigurinë e shëndetit të qytetarëve të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Fikrim Damka për Grupin “6+”.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” përkrah këto rekomandime të dala nga Komisioni për Bujqësi dhe Pylltari.

Unë besoj se tre muaj ky Komision dhe anëtarët e Komisionit, sidomos grupi punues ka bërë një punë të mirë dhe ka caktuar konstatimet dhe rekomandimet. Unë besoj se Qeveria do të marrë përsipër këto rekomandime për të vepruar. Faleminderit!

KRYESUESI: Melihate Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Unë shumë shkurtimisht, vetëm një dy-tre fjalë do t’i them rreth kësaj çështjeje.

Në fakt, mendoj se është një nga çështjet shumë serioze, që ka ndodhur në Kosovë, po fatkeqësisht, te ne po ndodhin aq shumë çështje serioze, sa po e zënë njëra- tjetrën dhe sikur nuk po kemi mundësi dhe nuk po kemi kurajën e plotë për t’i zgjidhur të gjitha këto probleme.

Kemi një rast shumë unik. Ushqimi për kafshë është përdorur si ushqim për njerëz. Dhe, kjo nuk është çështje e vogël, është një çështje shumë serioze.

Unë e dëgjova raportin dhe rekomandimet që i ka bërë Komisioni, mirëpo mendoj që edhe raporti edhe rekomandimet nuk janë në harmoni dhe janë në diskrepancë me dëmin i cili është shkaktuar me përdorimin e këtij materiali apo të këtij produkti i cili ka qenë i paraparë për kafshë.

Dëmi është shumë më i madh se sa masat e parapara. Ky është jo vetëm një mashtrim për qytetarët, por ndoshta mund të hyjë edhe në radhën e krimeve dhe dikush duhet ta lexojë dhe duhet të sqarojë këtë çështje se a është vetëm mashtrim për qytetarët apo është një lloj krimi që iu ka bërë qytetarëve të Kosovës si qytetarë dhe si konsumatorë.

Masat ligjore duhet të jenë karshi veprës dhe karshi dëmit që është bërë, si dhe duhet të kemi një raport të Qeverisë, ju lutem, shumë raport të Qeverisë të paraparë me afat të caktuar. Nuk mund të themi se Qeveria do të raportojë para këtij Kuvendi infinit, pa kufij. Duhet të përcaktohet një afat i raportimit të Qeverisë për masat e ndërmarra për shkeljen e ligjeve, qoftë nga ana e këtyre institucioneve që u përmendën - Agjencia e Ushqimit, Instituti dhe Doganat, dhe mendoj që

masat më të vogla janë që ata njerëz duhet të japin përgjegjësi edhe individuale. Nuk ka përgjegjësi kolektive këtu, dhe nuk po flasim vetëm për rrezikimin e shëndetit të individit. Ju lutem shumë, çdo vend të botës, çështja e ushqimit të qytetarëve është edhe çështje e sigurisë kombëtare, prandaj ne sikur këto çështje po i lëmë çështje jashtë rregullit dhe jashtë konsideratave tona për të gjetur një zgjidhje të duhur. Nuk mund të sillemi sikur nuk ka ndodhur kurrëgjë, prandaj ju lutem ajoj çka është realizuar, ajo çka ka ndodhur duhet të merren masat përkatëse. Ju lutem shumë anëtarë të Komisionit që e keni trajtuar këtë çështje t'i parashihni edhe masat përkatëse, adekuate karshi veprës dhe dëmit që është bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

E lexova raportin e Komisionit, më pëlqej, por megjithatë mendoj se drejtimi i tyre vetëm në vlerësimin e çështjes së grurit është ndoshta një fushë shumë e ngushtë, por meqë jemi në Kosovë dhe ushqehemi vetëm me grurë, është i rëndësishëm.

Komisioni i cili ka qenë në mandatin e kaluar, kemi pas Ligjin për ushqimin dhe në fushat ku diskutohet për ushqimin si produkt kryesor për ne ka qenë mjaft i rëndësishëm që të vlerësohet kjo, dhe ushqimi i sigurt, a ushqehen shqiptarët me ushqim të sigurt në Kosovë apo jo, apo qytetarët. Kemi pasur dyshime që herët, dhe këtë e kemi kërkuar disa herë nëpër raporte tona që kemi folur në Kuvend, kemi debatuar në Kuvend, kemi diskutuar për këto çështje se a e kemi një ushqim të sigurt, në shumtën e rasteve kemi dalë se nuk e kemi një ushqim të sigurt.

Dhe, për ta dëshmuar këtë ne e kemi marrë një raport, që e kemi bërë në 2013 dhe kemi kërkuar pikërisht për qumështin dhe aplatoksinën dhe kur thuhet se edhe në laboratorët e BE-së që janë bërë të gjitha këto ka dal me sasi të rritur me aplatoksinë. Ky raport është pranuar më 22.2.2013.

Ndërsa, për mostrat tjera që janë bërë, por ajo që nuk është vetëm gruri, por është edhe misri. Janë produkte me të cilat ushqehen edhe kafshët edhe njerëzit dhe të cilët përcjellën ose barten me të gjitha llojet e sëmundjeve të njerëz it.

Ushqimi që është marrë, për shembull misri dhe është me aplatoksinë, është më 14 dhjetor 2013, që ka ardhur nga Serbia, ka ardhur me sasi të mëdha të cilat kanë qenë shumë të dëmshme dhe thotë se nga 161 mostra 19 kanë dalë me rezultate pozitive me aplatoksinë, të cilat kanë ndikuar dhe ndikojnë me të cilin misër janë ushqyer kafshët dhe pulat. Kështu që, ato elemente kimike i kemi pasur edhe në ushqimin tonë, edhe në mish, edhe në produkte të qumështit, edhe në vezë.

Po ajo që duhet të thuhet, është se konsumatorët dhe dogana jonë, Agjencia e Ushqimit, nuk janë të gatshëm ose nuk janë fort të përgjegjshëm për mbrojtjen e konsumatorëve tanë. Për mbrojtjen e tyre ne kemi kërkuar të vendosen laboratorë nëpër dogana dhe të vendosen analizat e tyre dhe t'i mbrojmë qytetarët.

Mbrojtja e qytetarëve është e rëndësishë së veçantë pikërisht, sepse rastet e rritjes së sëmundjeve kancerogjene janë vetëm në 3 muajt e parë diku afër 300 raste të diagnostifikuar me kancer. Kjo tregon se atë që e hamë ne si ushqim, ai është një produkt me elemente kimike, që konsumatorët

nuk e dinë, por ato spërkatën me elemente kimike të gjitha që me afat shumë më të shpejtë të piquen e të qiten në treg dhe ajo pjekje ndikon negativisht në shëndetin e njerëzve.

Prandaj, ardhja e produkteve ushqimore nga jashtë, si ai i grurit, e misrit apo e të gjitha produkteve tjera që hyjnë në Kosovë, nuk e kanë një kontroll që duhet t'i mbrojnë.

Unë e pashë një deklaratë të ministrit të Bujqësisë ku tha se deri në vitin 2020 do të kemi 500 milionë grande e subvencione në investime në bujqësi, që është një dëshirë shumë e fuqishme, por një mundësi shumë e vogël për shkak se këto grande nuk po e ndihmojnë Kosovën, por vetëm kemi një bujqësi intensive ushqyese, por jo edhe riprodhuese ose përpunuese, prandaj derisa nuk kemi një plan strategjik të zhvillimit të bujqësisë, besoj që edhe këtu do të kemi ngecje.

Neve na duhet që ky raport të jetë i rëndësishëm, edhe pse është vetëm me një kahe në raport me grurin, neve na duhet të mbrojmë dhe të kërkojmë nga Agjencia e Ushqimit për mbrojtjen e ushqimit, sepse aty ushqehemi dhe aty mund t'i marrim të gjitha sëmundjet dhe për t'u mbrojtur nga sëmundja është më e mirë parandalimi ose preventiva sikur që thuhet në mjekësi, se sa të vendoset pastaj angazhimi i shpenzimeve dhe të gjitha tjerave për shërim.

Unë mendoj se këta duhet të dalin më shpesh dhe ta thirrin Agjencinë më shpesh në diskutim, në debat në Komision dhe ata të japin llogari dhe të kërkojnë përgjegjësi. Me anë të përgjegjësisë mund ta ngremë cilësinë, mund ta mbrojmë konsumatorin dhe duhet t'i mbrojmë produktet tona, sepse njerëzit tanë kanë mundësi më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: E ka fjalën Donika Kadaj-Bujupi, për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryesues!

Realisht kemi qenë në këtë Kuvend, më kujtohet, në qeverisjen e kaluar menjëherë pas pavarësisë së Kosovës, kur kanë ndodhur gjëra për të cilat edhe atëherë kemi paralajmëruar se do ta dëmtojnë vendin në vazhdimësi. Ka qenë viti 2008 kur kjo Agjenci me insistim të kryeministrit Thaçi, atëherë është bartur në kryeministri dhe është ditur dhe thënë në këtë Kuvend nga kolegët e mi deputetë që qëllimi është për të monopolizuar gjithçka dhe për të kontrolluar gjithçka.

Ajo ku kemi mbërri sot është realisht një kontroll i politikës mbi çdo përpjekje për të sjellë një ndryshim në kuptimin e Agjencisë, të zhvillimit të tij, por edhe të punës dhe të performansës dhe sigurisht që kjo performansë nuk mund të japë rezultate.

Kjo Agjenci më shumë është shfrytëzuar prej kryeministrit Thaçi, në fillim e më pas edhe prej pasardhësve të tij për të kontrolluar dhe kontrabanduar atë çka u ka përshtatur dhe për të bërë të kundërtën kur kanë pasur nevojë. Do të thotë, nuk mund ta drejtojmë gishtin nga individ, sepse bëhet fjalë për një shtet i cili përmes ndikimit të tij ka kontrolluar gjithçka që është lidhur me import dhe Agjencia ka qenë më shumë simbolike se që në fakt ka pasur një rol ose ka pasur ndonjë rezultat në punën e vet.

E dimë të gjithë se kush janë përgjegjësit dhe mendoj se kjo mënyrë e qeverisjes dhe kontrollit e monopolit na kanë sjell këtu ku jemi sot.

Mendoj që puna që është bërë nga kolegët deputetë, ka dhënë disa rekomandime të cilat janë të mirëfillta, por fakti që nuk i kemi këtu të paktën një ministër nga 22 ministri sa i ka Qeveria me dëgjua raportin e komisionit, jep pak shpresë se këto rekomandime do të zbatohen. Faleminderit!

KRYESUESI: E ka fjalën Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Deputetë dhe qytetarë të nderuar të Kosovës,

Kosovës, me tokën e saj pjellore, sipërfaqet e të cilës për fat të keq çdo ditë po zvogëlohen për shkak të ndërtimeve të pakontrolluara, me klimën e përshtatshme, me mundësi për ujitje, me bujq të mirë dhe numër të mjaftueshëm të ekspertëve, me shumë të rinj që kanë nevojë për vende pune, i mungon vetëm politika e drejtë e Qeverisë për zhvillimin e këtij sektori shumë të rëndësishëm ekonomik që do të hapte shumë vende pune. Kështu do të mbeteshin në vend qindra milionë euro që aktualisht po shpenzohen jashtë vendit për blerjen e artikujve ushqimorë, artikuj që shpesh kanë përbërje të dyshimtë, siç ishte importi i miellit për kafshë dhe shumë importe të ngjashme që pa u pengua hynë në Kosovë për shkak të interesave që kanë importuesit e pandërgjegjshëm dhe përkrahësit e tyre të korruptuar brenda institucioneve të vendit.

Gabojnë të gjithë ata që mendojnë se bujqësia në Kosovë mund të zhvillohet me këtë nivel të ulët të investimeve, me këtë ndarje jo të drejtë të subvencioneve dhe grandeve pa mbrojtje të prodhimeve vendore nëpërmjet politikave doganore, pa përkrahjen e ngritjes së kapaciteteve prodhuese të prodhimeve bujqësore të prodhuara në Kosovë.

Edhe ato pak kapacitete prodhuese në Kosovë që lëndë të parë i kanë prodhimet bujqësore shpesh lëndën e parë e importojnë nga vendet ku shkalla e subvencionimit të prodhimeve bujqësore është shumë më e lartë se në Kosovë. Rrjedhimisht prodhimet e tyre janë më konkurruese në treg, kështu që prodhimet vendore mbeten pa treg, kështu demotivohen bujqit tanë, kështu të rinjtë në vend që të orientojnë nga këto vende pune ikin, sepse puna në bujqësi, në këto kushte, nuk iu ofron kurrfarë mundësie për jetë normale.

Qeveria e Kosovës e ka për obligim që të orientojë shumë më shumë mjete në bujqësi si në formën e subvencioneve, e po ashtu edhe në formë të grandeve.

Qeveria duhet t'i pengojë nëpërmjet mekanizmave legalë stërngopjen e tregut të vendit me prodhime që hyjnë në Kosovë pa paguar doganë ose duke paguar një doganë sa për sy e faqe dhe kështu e pamundësojnë shitjen e prodhimeve të bujqve vendorë.

Qeveria duhet të mos lejojë futjen e mallrave të dyshimtë e të dëmshëm për shëndetin e qytetarëve nga matrapazët që janë lidhur me njerëzit me ndikim në këtë vend.

Bujqësia është mundësi e pashfrytëzuar në këtë vend, që duhet patjetër të shfrytëzohet për të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Ajo nuk guxon të mbetet peng e krimit të organizuar.

Ajo që sot e tha deputeti Salih Salihu, është ftesë e hapur, ftesë publike për Prokurorinë që t'i fillojë hetimet kundër atyre që po bëjnë krim jo vetëm ndaj bujqësisë por edhe ndaj shtetasve, pra qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Unë i përkrah rekomandimet e Komisionit dhe shpresoj që Qeveria në përputhje me këto rekomandime do t'i marrë masat e nevojshme për ta ndërruar këtë gjendje aspak të lakmueshme në bujqësi. Faleminderit!

KRYESUESI: E ka fjalën Shaip Muja, pa grup.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë si pjesëmarrës në grup për nxjerrjen e këtyre rekomandimeve të Komisionit për Bujqësi dhe planifikim hapësinor nuk jam dakorduar me këto rekomandime dhe aq më shumë jam i befasuar me konkludimet e deputetëve kur thonë - jam dakord dhe tregojnë se nuk kanë lexuar dhe nuk janë thelluar.

Po shkoj me radhë. Në çdo rekomandim, deputetët e Republikës së Kosovës duhet të kuptojnë rolin e tyre për çka janë deputetë. Ne jemi ligjvënës, ne bëjmë miratimin e ligjeve, ne thirremi në ligjet kur shkelen, dhe thirrmi në nenet ku preken, por jo në romantizëm, në forma dëshirore dhe në format hipotetike. Prandaj, unë kam kundërshtuar, sepse kam thënë se cili ligj është shkelur këtu, ne duhet ta cekim, nën pikën 1.

Në pikën 2, janë futur rekomandimet të cilat unë kam dashur t'i nxjerr, sepse me këto rekomandime nuk do të përfitojnë as bujqit as nuk do të përmirësohet performansa e kualitetit të ushqimit, por është thjeshtë një punë e cila do t'i arsyetojë mëditjet e Komisionit.

Ndërsa në pikën 3 thirren të ndryshohen politikat fiskale, apo për grurin e importuar. Ne nuk thirrmi çka na dëmton CEFT-a, çka na dëmtojnë ligjet e antidopingut apo të përmirësohen apo të mangësohen, por vetëm themi në mënyrë hipotetike.

Tjetra, në fund fare, të gjitha veprimet të cilat janë bërë mediatike përgjegjësia kryesore bie mbi kryeministrin dhe bie mbi ministrin e Bujqësisë.

Ministri i Bujqësisë para pak çaste këtu në binë, tha - unë nuk jam përgjegjës për ushqimin dhe pres që ta marrë Agjencinë e Veterinës në mbikëqyrje në Ministrinë e Bujqësisë. Do të thotë, është një diçka e cila është kundër standardeve të Bashkimit Evropian. Agjencia e veterinës është institucion i pavarur, ndërsa në raportimet ditore apo operative raporton në Zyrën e kryeministrit dhe vepron sipas ligjeve të cilat janë sponsorizuar dhe mbrojtur nga politikëbërësit.

Kush janë politikëbërësit këtu? Politikëbërësit dhe monitoruesi bashkë implementues praktik është Qeveria me ministrin e sektorit, të dikasterit, prandaj këtu tregohet qartë se kjo Qeveri nuk është e interesuar të krijojë kualitete të ushqimit.

Unë kam kërkuar në pikën 1 që të shkarkohet kryeministri i Republikës së Kosovës zoti Isa Mustafa, për çështjen e mos kualitetit të ushqimit nëse veç po domi të bëjmë politikë dhe, ministri i Bujqësisë, zoti Memli Krasniqi, sepse deklarojnë se nuk janë përgjegjës.

Analiza e cila ka shkuar, ne kemi dyshuar të gjithë, çfarë milli po hamë ne dhe analiza e cila ka shkuar në Gjermani ose në shtete tjera, se diku ka shkuar dhe gazetarët e dinë saktë dhe më mirë se ne deputetët se analiza qenka mirë, rri në kryeministri dhe tek ministri i Bujqësisë dhe këta thonë: mos gaboni ta publikoni se ne i kemi do pazare politike. Cilat janë pazaret politike, këtu? Pazaret politike janë që të merret Agjencia e Veterinës, të punohet kundër frymës së standardeve evropiane, që kanë investuar shumë në Agjencinë e Veterinës dhe duhet të investohet ende dhe tutje.

Po ashtu janë kundër standardeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. I sugjeroj kolegët tonë ta lexojnë çka është Agjencia e Kontrollit të Ushqimeve dhe të Barnave në Amerikë? Është shtylla ndoshta më kryesore pas presidentit të Republikës. Në shtetet evropiane të cilat i kanë ngritur standardet e kontrollit të cilësisë, i kanë krijuar mekanizmat e tillë të pavarur që nuk ndikohen nga politika, por kryejnë obligimet konform ligjeve.

Prandaj, këto rekomandime nuk do të bëjnë asgjë, këto rekomandime do t'ia hapin vetëm rrugën për ta zgjidhur një kryeshef të vetin, zoti Isa Mustafa, për t'i bërë disa punonjës të vet Qeveria nëse janë marrë vesh së bashku me partnerin e koalicionit tash të partisë tonë dhe nuk do të sjellin ndonjë cilësi.

Metodologjia e punës së këtij Komisioni është kryekëput shkelëse. Është shkelëse dhe duke mos ditur ligjin kanë kryer disa veprime të cilat nuk përkojnë as me obligimet e deputetit. Prandaj, unë i kam kundërshtuar dhe kam propozuar që ne nëse mendojmë ta ngremë kualitetin e ushqimit, sigurimin e ushqimit dhe cilësinë e ushqimit, ne duhet të prekim në ligjet të cilat i dhënë hapësirë edhe operatorëve edhe i dhënë hapësirë mundësisë së lëshimeve të mundshme në sistemin, qoftë fiskal apo qoftë doganor.

Këto rekomandime nuk bëjnë përveç mënyrës dëshirore dhe besoj se zoti nënkryetar si gjuhëtar e kupton më mirë se sa unë edhe nga aspekti gramatikor, po edhe nga aspekti i fjalive dëshirore çka thotë ky rekomandim. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë i thërras deputetët të vijnë në sallë se do të punojmë ende. Janë edhe katër veta që donë të flasin. Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se sot kemi një raport tepër të rëndësishëm për të analizuar dhe për të dhënë rekomandime adekuate që do të jenë në funksion të riparimit të kësaj gjendje dhe avancimit të proceseve që ndodhin atje.

Mendoj se në këto 16 vjet të kaluar bujqësisë nuk i është dhënë rëndësia që e ka merituar Kosova. Në tri projekte që realisht do ta rrisin vëllimin e prodhimeve ushqimore janë, nuk kemi ne edhe sot një studim të benefitit të tokës nëpërmjet të cilit do të tregohet se cilat kultura janë adekuate për hapësirën apo parcelat e caktuara.

Mendoj se ky do të jetë një projekt i gjatë, shumë studioz dhe i kushtueshëm, por është tepër i rëndësishëm për të mund Kosova të sigurojë ushqimin.

Pastaj është meliorimi, që ndodhin, dhe me investime të vogla mund të riparohet shumëçka. Ne jemi dëshmitarë që edhe në vjeshtë edhe në pranverë, hapësirat e mëdha vërshohen për investime shumë të vogla. Dhe në anën tjetër, çështja e ujëtjes si një element kyç për strukturën e tokës dhe nevojave të kulturave bujqësore, mendoj se në këto 16 vjet pak është punuar dhe nuk po shoh se ka ndonjë projekt afatgjatë që shkon në këtë drejtim.

Unë do të ndalem tek disa çështje që këtu u konstatuan dhe mendoj se rekomandimet duhet plotësuar edhe me rekomandime tjera shtesë. Ne e dimë që Agjencia Kosovare e Ushqimit - AUK, ka qenë në përbërje të cilën e thanë shumë kolegë dhe i dimë transaksionet që janë tërheq ose janë vepruar, janë marrë prej Ministrisë së Bujqësisë dhe janë qit te kryeministri dhe ato kanë qenë do lojëra politike, mos të harrojmë, pra që atëherë se nga puna janë larguar jo më pak se 69 vetë me një SMS dhe ata kanë paditur, e padia e tyre është realizuar dhe pritët kthimi i tyre në punë, që do tu kushtojë me pagesa me vite.

Këto janë bërë krejt për motive politike, por ana tjetër, që është shumë e dhembshme se laboratorit në të cilin janë investuar miliona e që kanë garantuar standarde të kërkuara për ushqim, në momentin final është ndërruar drejtori, janë bërë akrobacione dhe laboratorit, flas sipas raportit të auditorit, konstaton se instalimet, pajimet e instaluar në AUK, nuk garantojnë standarde.

Ky konstatim nuk është i sotëm. Ky është bërë para 5 viteve dhe ne nuk kemi marrë asnjë veprim. Do të thotë, zyrtarisht thuhet, në një institucion shumë kredibël se pajimet nuk sigurojnë standarde dhe ne vazhdojmë edhe më tutje të merremi ose me mostra jashtë ose t'i mbyllim sytë dhe pasojat ne po i trajtojmë sot.

Prandaj, unë e kisha thirrur prokurorin, se e thirri, tha deputetët le të lajmërojnë, deputetët nuk janë informatorë. Ai i ka këto në ueb-faqe, ai dhe të gjithë tjerët që merren me këtë punë. Pse nuk kanë ndërmarrë, pse nuk ndërmarrin? 5 vjet janë. Pajimet që janë të instaluar në Institutin e Ushqimit në AUK nuk sigurojnë standarde të kërkuara. A i duhet edhe diçka tjetër?

Krejt këto janë bë për qëllime personale, të kontrabandimit dhe unë mendoj se është koha e fundit që ne të marrim një analizë paraprake, që ta ndajmë shapin prej sheqeri dhe pastaj të merren veprime konkrete, sepse kështu është koha e fundit dhe kështu s'mund të ecim.

Unë mendoj se e kemi shansin që t'i kthejmë te Komisioni edhe një herë dhe ta plotësojmë me rekomandime adekuate, në bazë të këtyre fakteve. Ky raport i ka ardhur Kuvendit, i kemi kaluar dhe anashkaluar edhe pse Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike edhe atëherë i ka ngritur këto gjëra dhe deri sot nuk është ndërmarrë kurrëgjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Besa Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,
Të nderuar deputetë,
Qytetarë të respektuar,

Vetë fakti që Serbia me planet e veta njëqindvjeçare ka punuar dhe po vazhdon të punojë në forma të ndryshme për të dëmtuar popullin shqiptar, nuk është e rastësishme edhe kjo që po ndodhë përmes ushqimit të dyshimtë, përkatësisht nëpërmjet grurit që po e dëmton shëndetin e qytetarëve të Kosovës.

Importi i mallrave nga Serbia paraqet rrezik potencial për shëndetin e qytetarëve të Kosovës, duke e ditur gjendjen në veri, ku një numër i madh i mallrave ushqimore hyjnë në mënyrë ilegale, por duke ia shtuar kësaj edhe ndihmën tjetër lehtësuese që po i bëhet nga njerëz të ligj edhe nëpërmjet rrugëve legale.

Ka dyshime se Serbia ka linja të veçanta të prodhimit vetëm për Kosovën. Edhe gruri i importuar është i dyshimtë, sepse është grurë që ka qëndruar për një kohë të gjatë në depo, e si i tillë është i dëmshëm për shëndetin.

Në raport vërejmë se ka mospërputhje ndërmjet asaj çka është gjetur në dokumentet, qoftë në AVUK, Doganë dhe Institutin Bujqësor të Kosovës.

Është shumë shqetësues fakti se Instituti i Bujqësisë nuk është i akredituar, si dhe megjithëse në procesin e verifikimit kopjet e formularit të analizave të grurit gjendshin në Institutin e Bujqësisë, ndërsa kur është kërkuar mostra e analizuar, ajo nuk gjendej. E kjo, të nderuar deputetë, nuk do koment.

Ky raport është mirë i përgatitur, por do të duhej që këtu ta kishim edhe dokumentin me analizat e bëra, sepse do ta shihnim se çfarë përbërje ka mielli, a i plotëson ky miell standardet evropiane për proteina, që është 14%, sa është sasia e alfatoksinës, sepse është një bashkëdyzim tepër kancerogjen, e ne jemi dëshmitarë të asaj se numri i qytetarëve të sëmurë me kancer është në rritje, sidomos i qytetarëve të moshës së re.

Duke e ditur se Kosova nuk ka laborator për analiza specifike të produkteve të caktuara, këto produkte nga Serbia janë detektuar se përmbajnë materie kancerogjene, por jo në laboratorët tanë dhe do të vazhdoreshin këto produkte të shiteshin në tregun tonë, sikur të mos ishin zbuluar në shtetet e rajonit, të cilat, fatmirësisht, disa prej tyre janë tërhequr nga tregu.

Prandaj, të nderuar qytetarë,

Është në dorën tuaj të vendosni se cilat produkte t'i konsumoni, megjithëse në treg ju servohen produkte të dyshimta nga Serbia.

Megjithatë, unë i përkrah këto rekomandime që për mendimin tim janë shumë të buta në krahasim me atë se sa është dëmi i shkaktuar nga përdorimi i këtij gruri. Unë do të jem veçanërisht e interesuar ta përcjell punën e Qeverisë se çka do të ndërmarrë në këtë drejtim. A do t'i ketë për bazë këto rekomandime, do të shohim pas tre muajve, kur do ta sjellë raportin për të cilën e obligon ky rekomandim i Komisionit për Bujqësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Ky raport ka rëndësi, sepse po e adreson një shqetësim të madh që ishte në opinion para disa muajve dhe fatkeqësisht nuk na e jep përsëri një gjendje të qartë. Por, ajo që pasuron raportin është një zinxhir i papërgjegjësive në institucionet shumë të rëndësishme të këtij vendi.

Pra, kemi të bëjmë me një agjenci, me një doganë dhe me një institut që duhet ta kontrollojnë cilësinë e ushqimit, të dhënat e të cilave nuk përputhen lidhur me një importues apo më shumë importues. Domethënë, ka shumë konstatime, për mua shumë brengosësh, dhe Kuvendi e Qeveria nuk mund të kalojnë heshturazi dhe shpejt mbi këto konstatime.

Mendoj që këto duhet të analizohen mirë dhe të shkohet deri në fund kësaj çështjeje. Nuk mjaftojnë për mua veprimet e duhura në ngritjen e përgjegjësisë. Sipas të gjitha gjasave, prej asaj që po lexoj unë këtu, është fjala që dikush duhet të kaqë përgjegjësi, jo veç për ta rritur përgjegjësinë që është momentalisht, të bëhet pak më e madhe përgjegjësia. Situata është që dikush duhet të japë përgjegjësi, në qoftë se janë të sakta këto gjëra që i konstaton ky komision.

Dogana e Kosovës thotë gjithë gruri i importuar shkon për eksport, komisioni e konstaton të kundërtën. Si mund? Dogana e këtij shteti është një institucion shumë serioz dhe duhet të ketë të dhëna të sakta dhe duhet të japë deklarata të sakta.

Prapë ne themi duhet rritur përgjegjësinë? Këtu nuk është fjala që duhet ngritur përgjegjësia. Këtu dikush duhet të japë përgjegjësi prej këtyre institucioneve. Në këtë drejtim, mendoj se duhet të ashpërsohet ose të qartësohet, ose të precizohet gjuha e rekomandimeve dhe ndoshta është mirë që komisioni edhe një herë, megjithëse këto rekomandime u japin një drejtim të aktivitetëve, t'i precizojë pak më mirë.

Një çështje që u shtrua këtu e ka të bëjë me mbrojtjen e produkteve bujqësore, është një çështje që ne e diskutojmë dhe është shumë e rëndësishme, ndërlidhet edhe me grurin, edhe me qumështin, edhe me perimet, ndërlidhet edhe me shumëçka, mendoj se do të ishte qenë e nevojshme që Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Tregtisë ta analizojnë këtë situatë se çfarë po ndodh me këto produkte vendore në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së CEFTA-s dhe marrëveshjeve tjera, kur na importojmë produkte bujqësore që janë të subvencionuara në vendet e caktuara, e sidomos në sezonet e caktuara, të cilat i bëjnë një konkurrencë jo fer dhe jo të drejtë prodhimit vendor.

Në ato raste, institucionet tona, edhe me parimet e tregtisë së hapur dhe rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë mund të bëjnë masa mbrojtëse të përkohshme për masa sezonale mbrojtëse, të cilat e mbrojnë prodhimin vendor. Por, po theksoj edhe një herë: mbrojtja duhet të jetë deri në kufijtë që prodhimet tona i bën konkurrenë, e jo një mbrojtje pa kritere, e cila do të ndikonte në ngritjen e çmimeve të këtyre produkteve dhe në rënien e cilësisë së këtyre produkteve, e që do t'i dëmtonte konsumatorët, pra qytetarët e Kosovës.

Ne duhet ta kërkojmë këtë raport të ministrisë në këtë drejtim dhe të flasim me argumente. Faleminderit!

KRYESUESI: Mytaher Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Të nderuar kolegë deputetë,

Detyra jonë këtu në Kuvend është përfaqësimi i interesave të popullit të Kosovës, por kjo nuk ka ndodhur në të kaluarën, prandaj i kemi problemet të trashëguara me vite dhe nuk janë zgjidhur.

Ky është një ndër raportet e rralla, ose rastet e rralla kur Kuvendi i mbron interesat dhe të drejtat e qytetarëve të Kosovës, prandaj e uroj komisionin për punën e bërë, edhe pse mendoj që rekomandimet janë të buta. Më lejoni ta citoj një komunikatë për shtyp, të lëshuar nga Klinika Onkologjike Mjekësore e QKUK-së, para një muaji: “Në tremujorin e parë ka pasur 190 raste të reja të kancerit që janë lajmëruar në institucionin shëndetësor, prej tyre 52 tumore të gjirit, 35 tumore të sistemit respirator, 32 tumore të traktit gastrointestinal, 39 tumore të traktit urogenital dhe tumore gjinekologjike, 32 tumore të sisteme të ndryshme të tjera”.

Po ashtu, më lejoni të theksoj që këto raste të kancerit, ose këto raste të reja të kancerit nuk janë të vetmet, ngase shumë qytetarë të Kosovës kërkojnë ndihmë mjekësore jashtë Kosovës. Gjendja me rastet e kancerit është alarmante. Sipas literaturës, njëra ndër shkaqet kryesore të paraqitjes së kancerit është po ashtu ushqimi i dobët, ose ushqimi jocalësor, dhe me këtë raport po ashtu verifikohet që qytetarët e Kosovës i nënshtrohen një ushqimi jocalësor, apo në njëfarë aspekti të pakontrolluar nga shteti, që në afat të gjatë shkakton kancer të ndryshëm.

Pasi që e lexova raportin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me cilësinë e grurit të importuar, unë besoj që shumë nga këto raste të paraqitura të kancerit mund të kërkojnë dëmshpërblim nga qeveritë e kaluara të Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Instituti Bujqësor i Kosovës, ngase me mospunën e tyre dhe me korrupsionin që kanë bërë në kontrollin e cilësisë së grurit e kanë bërë një krim të rëndë dhe e kanë rrezikuar shëndetin e qytetarëve të Kosovës.

Në këtë aspekt, do të lexoj disa nga konkludimet e raportit, të cilat po i citoj: “10 mijë tonë të grurit të importuar si ushqim për kafshë është bluar dhe shitur edhe si miell për njerëz. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë gjatë vitit 2014 në Institutin Bujqësor të Kosovës ka dërguar 70 mostra për analiza, kurse sipas librave të evidencës së Institutit Bujqësor të Kosovës nga Agjencia dhe Dogana e Kosovës bashkë aty janë pranuar vetëm 30 mostra. Çka ka ndodh me 40 mostrat tjera, të cilat janë dërguar gjatë këtij viti.

Në vitin 2005 në Institutin Bujqësor të Kosovës janë dërguar 79 mostra, sipas evidencës së Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa sipas evidencës së Institutit Bujqësor të Kosovës, janë pranuar vetëm 14 mostra për analiza.

Çfarë ka ndodhur me 65 mostra, të cilat janë asgjësuar apo humbur?

Gjatë muajit qershor të vitit 2014 nga tërë sasia e importuar nga importuesit në këtë muaj, 5210 tonë ose 2208 maune grurë Inspektorati Fitosanitar i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë ka dërguar vetëm një mostër të vetme për analizë në Institutin Bujqësor të Kosovës dhe, njëjtë është edhe për vitin 2014, pastaj edhe më vonë për muajin nëntor 2014.

Po ashtu, në raport theksohet se përfaqësuesit e Doganës deklarojnë që janë importuar për ushqim diku rreth 500 tonë grurë. Në ndërkohë me statistika verifikohet, që janë importuar 10

mijë tonë grurë. Dallimi është njëzetfish. Pse fillimisht ata kanë thënë vetëm 500, e më vonë i kanë ndryshuar shifrat?

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës nuk është aspak në nivelin e detyrës dhe nuk bën kontroll të mirëfilltë në aspektin e sigurisë së ushqimit. Si pasojë, qytetarët e Kosovës nuk ushqehen me ushqim cilësor dhe të kontrolluar si duhet. Këto ishin konstatimet e raportit të Komisionit.

Më lejoni, t'ju njoftoj po ashtu, që gruri është përbërësi kryesor i ushqimeve bazike për popullatën e varfër të Kosovës, prandaj, institucionet përgjegjëse që kanë bërë lëshime të tilla për grurin, unë nuk mund të paramendoj se çfarë ata bëjnë me ushqimet tjera, të cilat janë më pak të konsumuara në Kosovë.

Duke i parë këto dhe të gjitha ato parregullsi që kanë ndodhur me kontrollin e ushqimit në Kosovë, mund të konstatojmë se gjersa në botë njerëzit vdesin aksidentalisht, në Kosovë njerëzit jetojnë aksidentalisht.

Shpresoj që rekomandimet të merren seriozisht nga institucionet përgjegjëse dhe të implementohen, por po ashtu ftoj Prokurorinë që raportin ta marrë si bazë për të filluar hetimet për keqpërdorimet dhe korrupsionin e bërë në këtë rast. Ju falënderoj për vëmendje!

KRYESUESI: Tash është Adem Salihaj. E ke përfundim apo çka e ke, se njëherë ke folur? A dëshiron të flasësh? Ti e ke fjalën.

ADEM SALIHAI: Unë desha të flas pak edhe në emër timin dhe të jap disa sqarime lidhur me disa shqetësime që u ngritën, këtu.

Unë nuk arrita në fund ta lexoj një rekomandim që përcakton një afat tremujor, që Qeveria t'i raportojë Kuvendit lidhur me masat e ndërmarra. Pra, në raport është rekomandimi lidhur me afatin.

E dyta, jemi kufizuar vetëm në çështjen e grurit për shkak të kapaciteteve, sepse ne jemi vetëm deputetë që merremi me këto çështje dhe, në fakt, ne kemi kryer një pjesë të madhe, që do të duhej ta kryente Qeveria. Ne po ia bëjmë gati Qeverisë atë që është dashur ta kryejë ajo, në mënyrë që ne të bëjmë diçka për kontrollimin e cilësisë së ushqimit.

Shqetësuese më së shumti është çështja e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, pra në raportimin para Komisionit, përfaqësuesit e kësaj Agjencie kanë pohuar se nuk është importuar asnjë kilogram grurë i ushqimit për kafshë. Në ndërkohë, që është konstatuar se janë importuar 10 milionë kilogramë grurë si ushqim për kafshë.

Pra, kanë qenë shumë të papërgjegjshëm dhe të pasaktë në raportimet e tyre.

Në anën tjetër, thonë që 100% e çdo kilogrami të grurit të importuar ka qenë në rregull. Pra, 100% ka qenë i mirë dhe i ka plotësuar të gjitha kriteret, që unë jam i bindur që nuk ndodh as në Suedi, as në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as në Japoni, që 100% të dalë çdo gjë e mirë,

veçanërisht gruri nga Serbia, që ka ngjallur menjëherë dyshimet tona dhe ne i kemi hyrë hulumtimit të kësaj çështjeje.

Po ashtu, ka pasur deklarime shumë kontradiktore edhe në Doganën e Kosovës edhe në Agjencinë e Ushqimit edhe në Institutin Bujqësor të Pejës, e tjera..., pra të gjitha këto na bëjnë të dyshojmë seriozisht që kontrolli i cilësisë së ushqimit në këto institucione nuk është ashtu siç duhet.

Ne s'jemi për çështje tjera, por dëshiroj vetëm kalimthi ta informoj Kuvendin se pothuaj 100% e misrit të importuar në vitin 2013 ka pasur materien kancerogjene aflatoksinë. Pra, pothuaj se 100% e misrit të importuar. E dini atë aferën e aflatoksinës në qumështin që ka qenë i eksportuar në Shqipëri, pra ka qenë pasojë e konsumimit të këtij misri nga kafshët dhe ata e kanë hetuar, e kanë kthye, por kjo çështje ka mbetur aty. Pra, të gjithë ne, pa përjashtim, jam i bindur që kemi konsumuar ushqime me aflatoksinë me origjinë bimore dhe shtazore, edhe të prodhimit të qumështit, edhe të vezës, të mishrave të shpezëve dhe kafshëve.

Pra, këtë çështje do ta hulumtojë komisioni për aq sa do të ketë sukses.

Në anën tjetër, te rekomandimet që vlerësohen se janë të buta. Unë pajtohem pjesërisht, por në esencën e rekomandimeve qëndron mundësia që Qeveria t'i ndërmarrë të gjitha llojet e masave, edhe përgjegjësinë, edhe shkarkimin, edhe ndjekjet dhe të gjitha tjerat, e ka mundësinë në bazë të rekomandimeve që ne i kemi shënuar aty.

Dhe, çështja tjetër që hapet këtu, çështja e mbrojtjes së prodhimit vendor. Nëse një importues importon grurë nga Serbia, ose nga cilido vend tjetër dhe nuk paguan asnjë lloj takse doganore, ai vetvetiu do të mund ta plasojë më lirë edhe miellin edhe grurin, edhe krundet dhe çdo gjë që vjen nga ai produkt. Ndërsa, prodhuesi kosovar nuk mund ta plotësojë me atë çmim, nuk mund ta plasojë për arsyen e thjeshtë sepse në Serbi ka subvencione më të mëdha për grurin se sa në Kosovë dhe prodhuesi në Serbi mund ta shesë më lirë dhe si pasojë ai plasohet edhe në tregun e Kosovës.

Pra, unë mendoj se Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë masa mbrojtëse për prodhimin vendor në çfarëdo forme që e vlerëson ajo se duhet të ndërmarrë, qoftë me moslejimin e importit të sasive të pakufizuara, sepse importimi i sasive më shumë se sa i duhen Kosovë e lë të pa shitur grurin e prodhuesve vendorë të Kosovës. Dhe unë mendoj se Qeveria mund të ndërmarrë hapa të nevojshëm që t'i mbrojë prodhuesit vendorë të grurit në Kosovë.

Në fund, unë përsëri i propozoj Kuvendit që t'i aprovojë këto rekomandime. Qeveria i ka duart e lira që të ndërmarrë të gjitha masat e duhura dhe që në të ardhmen ne të jemi më të mbrojtur nga cilësitë e dyshimta të ushqimit që marrim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Para se t'i hedh në votim këto rekomandime, po e bëjmë një marrëveshje me ju.

Unë ju propozoj që ta kryejmë edhe pikën e fundit, të tetën, kemi votime, në mënyrë që mos ta ndërprejmë se edhe ashtu vështirë po bëheni shumicë këtu.

Atëherë, i hedh në votim rekomandimet lidhur me pikën e rendit të ditës për të cilën biseduam. Janë gjithsej 7. Grupet parlamentare të gjithë i kanë përkrahur në parim dhe votojmë tash.

Regjia, edhe një herë votojmë se nuk janë të gatshëm deputetët. Atëherë, a jeni të gatshëm? Votojmë tash, edhe një herë.

Atëherë, rekomandimet kaluan me 59 vota për, 4 abstenime dhe asnjë kundër.

8. Zgjedhja e një anëtari të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Komisioni ad hoc për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga radha e komunitetit serb, i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raport me rekomandime.

Ftoj kryesuesen e Komisionit ad-hoc, deputeten Xhevahire Izmaku, ta paraqesë dhe arsyetojë raportin.

Zonja Izmaku nuk është këtu. Kush flet në emër të saj, ose të Grupit?
Nuk ka nevojë sepse s'është kurrkush.

Të nderuar deputetë ju ftoj që në pajtim me nenin 6 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe me rekomandimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidaturave për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga radha e komunitetit serb, janë propozuar 2 kandidatë si në vijim:

- Lejla Petković dhe
- Bogolub Staletović.

Kuvendi e zgjedh një prej tyre, me shumicën votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë me votim të fshehtë.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një Komisioni votues në përbërje nga 1 deputet prej secilit grup parlamentar, me mbështetje të zyrtarëve të administratës.

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga 1 anëtar. PDK, e ka fjalën, zoti Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!
Grupi Parlamentar i PDK-së e propozon Blerta Deliu.

KRYESUESI: LDK, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Ne e propozojmë deputetin Blerim Graincën!

KRYESUESI: Nga “Vetëvendosje”, Albulena e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Po kërkoj vëmendjen e deputetëve të Kuvendit për një çështje që po dëshiroj ta ngris. Së pari është dashur që këtu të jetë e pranishme zonja Izmaku, sepse duhet të na informojë nëse kandidatët që na janë propozuar i plotësojnë kriteret për të qenë kandidatë në Shërbimin civil, pra në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Sipas informacioneve që i kam, zonja Lejla Petković nuk i ka 5 vjet përvojë pune në Shërbimin Civil dhe për të qenë anëtar në këtë Këshill duhet t'i ketë 5 vjet përvojë pune në Shërbimin Civil, dhe së paku 5 vjet përvojë pune në Shërbimin Civil.

Për këtë arsye unë po propozoj që kjo çështje të shtyhet për sa kohë nuk i kemi informacionet e duhura. Nëse kjo nuk bëhet, atëherë Lëvizja “Vetëvendosje” nuk propozon asnjë kandidat në këtë Komision që do të formohet aktualisht.

KRYESUESI: Është çështje e Lëvizjes “Vetëvendosje” qysh voton e çka bën. Unë jam duke e drejtuar seancën. Në raportin ekziston. Raportin e kam edhe unë edhe ti me shkrim. Në raport ekziston, është punë tjetër a do ta komentoj dikush apo jo, është punë e tyre. Unë nuk e di...! Urdhëro, zoti Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Deputetja Xhevahire Izmaku veç që s'ka ardhur nëse është e domosdoshme ta lexojë raportin në emër të Komisionit, në mënyrë për të proceduar më tutje, do të thotë mund ta lexojë raportin. Përndryshe, raportin e kanë pasur të gjithë deputetët dhe nëse është kjo e vetmja arsye, atëherë ajo do të vjen tash dhe do ta prezantojë atë para deputetëve. Se, ajo i ka 6 vjet, sepse ka punuar pikërisht në komunë të Shtërpcës si nënkryetare, saktësisht.

KRYESUESI: Faleminderit! AAK, kë e propozoni, ju lutem? Donika, kë e propozoni?

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Aleanca e propozon deputetin Pal Lekaj, po në ndërkohë kërkojmë që kryesuesja të vjen dhe të japë sqarimet për të cilat kërkoi “Vetëvendosja”. Do të thotë, ta dimë për çka po bëhet fjalë, a qëndron apo s'qëndron fakti që një kriter kryesor nuk është përmbushur.

KRYESUESI: “Nisma”, kë e propozon?

ENVER HOTI: Shukrije Bytyqin.

KRYESUESI: Grupi “6+”?

MÜFERA ŞINIK: “6+” Parlamenter Grubu Kuytim Paçaku'yu öneriyor!

KRYESUESI: Kujtim Paçaku! Lista Serbe

SAŠA MILOSAVLEVIĆ: Mi predlažemo Jelenu Bontić, za člana komisije!

KRYESUESI: “Vetëvendosje”? Nuk do. Kërkoj që Komisioni të mblidhet dhe ta nisë punën.

A jeni të gatshëm? Atëherë, po fillojmë:

Adem Grabaovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Sylja, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Enver Hoxhaj, Etem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Margarita Kadriu, Melihate Tërmkolli, Mexhide Mjaku, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Millka Vuletiq, Mufera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashić, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Shala-Berisha, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavljević, Selviqe Halimi, Sërgjan Popović, Shqipë Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipë Pantina, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petrović, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrija, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaqi, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

E ftoj kryesuesen e Komisionit votues, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë raportin për rezultatin e votimit për zgjedhjen e një anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit, për zgjedhjen e një anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, për Shërbimin Civil të Kosovës, nga radha e komunitetit serb, në mbledhjen plenare të mbajtur më 4 qershor 2015, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë gjithsej 65 deputetë. Të pavlefshme janë gjithsej 3 fletëvotime. Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

- Lejla Petković ka fituar 51 vota dhe
- Bogolub Staletović ka fituar 11 vota.

Në bazë të rezultatit të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit numër 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit konstatohet se zonja Lejla Petković, zgjidhet anëtare e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me mandat pesëvjeçar.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë në bazë të raportit të Komisionit votues, konstatoj se anëtare e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga radha e komunitetit serb, zgjidhet zonja Lejla Petković.

Mandati i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pesëvjeçar.

Me këtë e mbyll këtë seancë. Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*